GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7494 E diel 6 Gusht 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot më e mira ...

Opinioni i Ditës

Temperaturave të larta të kësaj vere të nxehtë afrikane që shqiptarët mezi po e përballojnë, këtyre ditëve iu "shtuan" edhe disa gradë të tjera artificiale, tashmë... Vijon në faqen 22

Nga BUJAR VANI

Skënderbeu "hungarez" dhe patriotizmi tenderist

Opinioni i Ditës

Kur Paul Percy Harris thirri për drekë dy miqtë e tij dhe në atë ditë shkurti të vitit 1905 vendosën të krijonin një klub që, për shkak se lëvizi nga një vend në një... Vijon në faqen 21

Nga PËRPARIM KABO

25 vite Rotary në Shqipëri

42-vjeçari, me precedentë penalë

Grabiste me armë me silenciator, kapet i tmerrshmi nga Berati

Si u zbulua Aleks Prifti, njeriu që kreu shtatë bastisje në tri ditë

Një 41-vjeçar nga Ura Vajgurore e Beratit, i cili ishte kthyer në tmerrin e pikave të karburantit dhe të argjendarive në disa qytete të ndryshme të vendit është arrestuar mbrëmjen e së premtes nga Policia e Shtetit. Bëhet fjalë për Aleks Priftin, i cili konsiderohet person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi vetëm brenda... Në faqen 5

FLET PAVLLO MIHALI: NUK KA ME KUPTIM JETA IME, JAM TE HA TRITOL

KAMPIONI I ATLETIKES: HUMBA DRITEN E SYVE

Vrasja te stadiumi "Selman Stërmasi", rrëfehet shoku i viktimës: Marvi nuk vdiq për celularin sepse ai ishte i imi



(Në foto) Pavllo Mihali, babai i Marvit. Marvi Mihali Në faqen 8

EKSPERIMENTI

Superaksioni në det, skafistët po transportonin 2.5 tonë drogë

Në faqen 7

AKUZA

Berisha: Rama piktor dështak, i varur nga droga e atletet

Në faqen 4

"STANDARD & POOR'S" E "MOODY'S"

Studimi: Ekonomia shqiptare mbetet stabël, priten reforma

Në faqen 9

LISTA E PLOTE

Ish-pronarët, 24 mijë dosjet në shqyrtim dhe përfituesit

Në faqen 12

MILONA U ruajt në arkivin personal të Dhimitër Shuteriqit, ish-kryetarit të Lidhjes së Shkrimtarëve

Dokumenti që ndau për herë të parë shqiptarët

Letërsia e realizmit socialist, kur nisi udhën e saj. Përplasja shfaqej si një konflikt mes së resë dhe së vjetrës

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri konflikti për mbështetjen ose jo të rezistencës së armatosur kundër nazi-fashizmit u shtri jo vetëm në qarqet politike, por edhe në mjediset intelektuale dhe kulturore të kohës. Shkrimtarët që

Nga ALBERT GJOKA

kishin marrë pjesë me armë në luftë, të mbështetur edhe nga strukturat politike, e vazhduan luftën e tyre për të realizuar edhe përmbysjen e sistemit letrar, me parimin e qartë se "letërsi është vetëm letërsia e Partisë". Fillimisht, përplasja shfaqej si një konflikt mes të resë dhe të vjetrës; mes përparimit dhe regresit. Këto debate zunë vend në media, në forume të ndryshme, por u bënë edhe pjesë e vetë artit. Ja se çfarë shkruhej në... Suplement

DEGJESAT
PROBLEMET

Kryeministri publikon përmbledhjen e shqetësimeve, pas dëgjesave publike

45 problemet e dibranëve, i ankohen Ramës për LSI-PDIU

Rezultati i zgjedhjeve, kërkohet riorganizim i PS-së

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama publikoi dje, 45 çështjet që shqetësojnë dibranët. Në raportin përmbledhës të hartuar pas dëgjesave një mujore, Rama ka renditur 10 problemet, që sipas banorëve kërkojnë zgjidhje emergjente në këtë qark. Problemi kryesor i dalë nga dëgjesat është infrastruktura, veçanërisht rruga nacionale Peshkopi-Tiranë, çështje të cilën e kanë ngritur 118 persona, gjatë dëgjesave. Më pas vjen mungesa e ujit të pijshëm dhe kanalet vaditës, të cilën e kanë ngritur 110 persona. Por, ajo që tërheq vëmendjen në listën e probleme të paraqitura nga Rama, bazuar te raporti i dëgjesave është shqetësimi i banorëve për politizimin e administratës dhe pengesat që kanë hasur nga koalicioni me LSI dhe PDIU në këtë qark. Kjo çështje renditet e nënta në listën e problemeve të ngritura dhe për të kanë folur 50 persona gjatë takimeve që organizoi PS, në qarkun e Dibrës. Në listën e 10 problemeve janë edhe papunësia, problemet me tokën dhe investimet në zonat rurale. Në Dibër, kryeministrit Rama i kërkuan edhe riorganizimin e Partisë Socialiste. Riorganizimi u kokrrua nga 37 persona në njësitë administrative Maqellarë, Melan, Sllovë dhe në Bashkinë Dibër. E ndërsa bën edhe një pasqyrë të rezultatit të zgjedhjeve të 25 qershorit, Rama fton të gjithë miqtë e rrjetit nga qarku i Dibrës të bëjnë sugjerime apo ankesa që sipas tyre mund të mungojnë në këtë raport. Pas turit të dëgjesave Rama ka paralajmëruar një reformë të thellë në administratë. Në qarkun e Dibrës në zgjedhjet e 25 qershorit, PS dhe PD morën nga dy mandate, LSI dhe PDIU nga një, ndërsa bashkia drejtohet nga PS. Statusi i minatorit është një çështje tjetër që shqetëson këtë zonë. 20 persona kanë ngritur këtë shqetësim në tre bashki të qarkut Dibër. Të tjera çështje janë renditur: rikonstruksioni i shkollave, mungesa e tregjeve dhe pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore, mungesa e alternativave për strehim sociale, etj. Po ashtu një pjesë e mirë në bashkitë Dibër, Bulqizë, Klos e Burrel kërkuan rritje të pensioneve të fshatit. Ndërsa një problem që vihet re në këtë qark është edhe amortizimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Infrastruktura e dëmtuar në institucionet arsimore, diferencimi në pagesën e invaliditetit, mungesa e investimeve në industrinë minerare, si dhe vendosja e taksave për transportin e mineraleve për të mirëmbajtur infrastrukturën rrugore, mungesa e hapësirave rekreative (parqe, kënde fëmijësh), mungesa e një kinemaje, infrastruktura në institucionet arsimore dhe klasat kolektive, subvencionimi i energjisë për pompat që përdoren në kanalet vaditëse, çmimet e larta të inputeve dhe pesticideve si dhe çmimi i naftës, mungesa e aksesit në shërbimin mjekësor parësor (mjekët në fshatra nuk shkojnë vazhdimisht), janë çështjet e renditura në fund të tabelës së 45 problemeve që ka grumbulluar skuadra e shënimeve të Kryeministrit Rama nga dëgjesat publike në qarkun e Dibrës.

Kryeministri Edi Rama

45 PROBLEMET E NGRITURA NGA DIBRANËT, GJATË DËGJESAVE PUBLIKE

1. Rruga Tiranë-Peshkopi në gjendje të keqe
2. Uji i pijshëm
3. Investim në sistemin e vaditjes në bujqësi
4. Investim në rrugët malore/dytësore (Mungesa e rrugëve lidhëse të fshatrave me rrugën kryesore)
5. Problemet me pronësinë e tokës dhe mbivendosjen e pronës
6. Nevoja për riorganizim të PS
7. Mungesë e theksuar e mjekëve specialistë në spitale
8. Mungesa e kanalizimit të ujërave të zeza
9. Politizimi i administratës dhe mungesa e theksuar në Administratë e specialistëve (LSI dhe PDIU).
10. Papunësia
11. Statusi i minatorit
12. Rivitalizimi i rezervuarëve vaditës
13. Transporti i nxënësve /Lidhja e kontratës për transportin e nxënësve
14. Rikonstruksion shkollash
15. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe i urgjencës mjekësore
16. Shërbimi ekstensionit nuk ka funksionuar
17. Mungesa e tregjeve dhe pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore
18. Mungesa e investimeve në turizmin lokal
19. Punësimi i mësuesve jo sipas kritereve
20. OSHEE: kabinat elektrike dhe rrjeti shpërndarës i amortizuar.
21. Mungesa e alternativave për strehim social
22. Afrimi i zyrave të shërbimeve pranë qytetarëve (pagesat e tarifës së OSHEE, ndihma ekonomike, pensionet)
23. Investim në infrastrukturën sportive
24. Afrimi i sipërmarrjeve private - fasone
25. Hapja e degëve të reja me fokus agro-pylltarinë, minierat dhe rritja e kapacitetit të shkollës profesionale
26. Investim në mbrojtjen e mjedisit, lumenjtë, pyjet etj.
27. Rritja e pensioneve të fshatit
28. Amortizimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike
29. Infrastruktura e dëmtuar në institucionet arsimore
30. Diferencimi në pagesën e invaliditetit
31. Mungesa e investimeve në industrinë minerare, si dhe vendosja e taksave për transportin e mineraleve për të mirëmbajtur infrastrukturën rrugore
32. Mungesa e hapësirave rekreative (parqe, kënde fëmijësh)
33. Mungesa e një kinemaje
34. Infrastruktura në institucionet arsimore dhe klasat kolektive
35. Subvencionimi i energjisë për pompat që përdoren në kanalet vaditëse
36. Çmimet e larta të inputeve dhe pesticideve si dhe çmimi i naftës
37. Mungesa e aksesit në shërbimin mjekësor parësor (mjekët në fshatra nuk shkojnë vazhdimisht)
38. Çështja e shpronësimit
39. Rritje e kontrollit për lejet e shfrytëzimit të HEC
40. Mungesa e infrastrukturës për tregtimin e gjësë së gjallë
41. Mungesa e tregjeve
42. Rishikimi i largësisë së vendndodhjes së organeve administrative (Klos. Burrel. Dibër)
43. Vonesa në përgatitjen e dosjeve të pensioneve
44. Menaxhimi i mbetjeve urbane
45. Sistemi gjyqësor i korruptuar

DHURATA ÇUPI

"Dibra po përballet me një situatë të paprecedentë të zjarreve masive në malësitë e saj", ngriti dje, alarmin deputetja e PD-së Dhurata Çupi. Ajo u bëri thirrje qytetarëve të Dibrës të ndihmojnë për të ndaluar këtë situatë. "Nëse prisni qeverinë, do të jetë shumë vonë. Qeveria ka nisur pushimet dhe plazhet janë larg nga kurorat e gjelbërta të Dibrës apo çdo zone tjetër malore", tha Çupi.

5 grupet e punës do të raportojnë për situatën

Analizë në PS, kryetari Rama thërret Asamblenë më 25 gusht

Kryetari i PS-së, Edi Rama ka rënë dakord me drejtuesit e 5 grupeve të punës në PS që më 25 gusht të thërrasin mbledhjen e Asamblesë Kombëtare. Ky forum, i cili thirret pas zgjedhjeve të 25 qershorit, do të bëjë një analizë të rezultatit, që këtë herë ishte mjaft i mirë për PS-në, por njëkohësisht do të miratojë edhe një strategji të punës për mandatin e dytë të qeverisë. Pesë grupet e punës që janë ngritur menjëherë pas zgjedhjeve: ai për ristrukturimin e qeverisë, për reformën në administratë, për analizën e zgjedhjeve, për grupin parlamentar dhe për bashkëqeverisjen me qytetarët do të kenë gati deri në këtë datë raportet e tyre, të cilat do t'i paraqiten forumit të lartë. Në fokus të analizës dhe diskutimit do të jetë puna e bërë nga të deleguarit, kryetarët e bashkive dhe deputetët për rezultatin e votave në qarqe të ndryshme, për të parë ato zona se ku ka pasur rënie apo rritje Partia Socialiste, raporton newsbomb.al. Duket se përplasjet e para kanë filluar të bëhen konkrete, mes të deleguarve, kryetarëve të bashkive dhe deputetëve. Dhe analiza e shifrave dhe ndarja e zonave do të nxjerrë edhe përgjegjësitë. Në asamblenë e 25 gushtit, pikërisht në kulmin e vapës, Rama do të japë edhe direktivat e mandatit të ri qeverisës, ku siç është bërë tashmë e qartë, grupi i punës i drejtuar nga Niko Peleshi, ka propozuar një qeveri me 10-12 ministri.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: http://www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Operacioni ndërkombëtar çon në Kuvend rekomandimet për "avokatët" e KLP

Drejtësia, shefja e ONM: Krijimi i trupave të gjyqësorit është kyç

Shefja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Genovefa Ruiz Calavera deklaroi dje, se krijimi i trupave të gjyqësorit është kyç për zbatimin e Reformës në sistemin e Drejtësisë në Shqipëri. Drejtuesja e ONM-së, përmes një statusi në rrjetin social "Twitter" bëri me dije se ka dorëzuar në Kuvend rekomandimet për kandidatët e avokatisë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Për Këshillin e Lartë Gjyqësor janë dorëzuar në Kuvend kandidatët për Avokatinë dhe Shoqërinë Civile, ndërsa për KLP-në janë dorëzuar tani sipas Genovefa Ruiz Calavera, ndërsa në pritje janë edhe kandidatët nga akademikët. E ndërsa pak ditë më parë u zgjodh në krye të Komisionit të Kualifikimit të Vetingut Genta Bungo, dhe Natasha Mulaj në krye të Kolegjit të Apelimit. Deri në muajin tetor pritet që të ngrihen plotësisht organet e sistemit të ri të drejtësisë në Shqipëri me mbikëqyrjen e ONM-së, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Krijimi i institucioneve është emergjent, pasi aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk ka 3 anëtarë, ndërsa Gjykata e Lartë 10, një pjesë të të cilëve emërohen nga presidenti pa pëlqimin e Kuvendit, por Kreu i Shtetit i bën emërimet, pasi merr propozimet e kandidaturave nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i ngritur sipas ndryshimeve të reja kushtetuese.

Statusi i Genovefa Ruiz Calavera në "Twitter"

INSTITUCIONET

Pak ditë më parë u zgjodh në krye të Komisionit të Kualifikimit të Vetingut Genta Bungo, dhe Natasha Mulaj në krye të Kolegjit të Apelimit. Deri në muajin tetor pritet që të ngrihen plotësisht organet e sistemit të ri të drejtësisë në Shqipëri me mbikëqyrjen e ONM-së, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Shërbimi i Financës u ka dërguar ligjvënësve një email që të dorëzojnë kompjuterët

Mbyllen punimet, Kuvendi u kërkon deputetëve laptopët

Pas largimit të Topallit, u hoqën kompjuterët në sallë

Kuvendi u ka kërkuar përmes një shkrese zyrtare, të gjithë deputetëve që të kthejnë kompjuterët, të cilët i kanë përdorur gjatë detyrës së tyre në legjislaturën e tetë. Në një email që u ka mbërritur deputetëve në postën elektronike, u kërkohet që ata "të bëjnë dorëzimet", ose më saktë të kthejnë ato që u janë vënë në dispozicion gjatë katër vjetëve. Dhe mes këtyre gjërave është edhe një laptop, të cilin Kuvendi ia ka dorëzuar secilit deputet që në vitin 2013. "Të ndëruar deputetë, na lejoni që të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë legjislaturës VIII, ju jeni pajisur me laptop nga Kuvendi i Shqipërisë, për të cilin keni firmosur kartelën përkatëse të marrjes në dorëzim pranë shërbimit të Financës së Kuvendit. Për sa më sipër, lutemi në mirëkuptimin tuaj, për dorëzimin e tyre pranë shërbimit të Financës, duke qenë se përfunduan punimet e legjislaturës së 8-të", thuhet në email-in e Kuvendit për deputetët. Çështja e kompjuterëve u kthye në debat pak vite më parë në Kuvend. Në muajt e fundit të detyrës së saj si kryeparlamentare, Jozefina Topalli iu vendosi në seancën plenare deputetëve nga një kompjuter, i cili u refuzua edhe nga vetë ligjvënësit. Ata u ankuan se kompjuterët mbi tavolinë i pengonin të ndiqnin folësin në seancë, dhe se ishin të shqetësuar që ekrani i madh mund të monitorohej qoftë nga kolegët pas tyre, qoftë nga kamerat e televizioneve, që në seancë rrinë në lozhën mbi sallën e seancave. Në këto kushte kur deputetët ndiheshin jo komodë dhe pretendonin se iu cenohej privatësia, ndër gjërat e para që Meta bëri në krye të parlamentit, ishte heqja e këtyre kompjuterëve, dhe pajisja e çdo deputeti me një laptop. Mirëpo tashmë që në krye të Kuvendit do të vijë një tjetër emër dhe, sigurisht, do të ketë rregulla të reja, duhet që punonjësit përgjegjës për bazën materiale të bëjnë inventarin dhe të lënë në rregull çdo gjë. Edhe pse ende nuk ka përfunduar e gjithë periudha ligjore që deputetët aktualë të dorëzojnë mandatet dhe privilegjet që gëzojnë, duket se administrata e Kuvendit po nxiton që të mos gjendet në vështirësi, pasi një pjesë e mirë e deputetëve aktualë nuk do të jenë më në Kuvend gjatë 4-vjeçarit të legjislaturës së nëntë. Pajisja me mjetet e punës për deputetin është vetëm një detaj, krahas pagës që vjen pas asaj të ministrit, por që shtohet në varësi të pjesëmarrjes në seancë dhe punimet e komisioneve dhe pozicioneve që kanë në komisione dhe grup parlamentar. Deputetët marrin dieta për lëvizjet brenda dhe jashtë vendit si dhe pagesa e pensione suplementare, pasaporta diplomatike për vete dhe bashkëshortin përkatës për 7 vjet dhe shërbim telefonik. Veç anës logjistike dhe mbështetjes financiare, ligji për statusin e deputetit i jep atij të gjithë autoritetin për të qenë i angazhuar për të kërkuar llogari e për të vepruar në të mirë të zonës elektorale që e ka zgjedhur. Madje duke qenë aktiv, nga mbledhjet e këshillave bashkiakë e deri tek ato të qeverisë. Drejtuesit kryesorë të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore detyrohen të presin me përparësi deputetin sa herë që ky kërkon takim për problemet që lidhen me ushtrimin e detyrës së tyre; - është një tjetër pikë me rëndësi për statusin e tyre.

Gjatë një seance parlamentare

KOMPJUTERËT

Në muajt e fundit të detyrës së saj si kryeparlamentare, Jozefina Topalli iu vendosi në seancën plenare deputetëve nga një kompjuter, i cili u refuzua edhe nga vetë ligjvënësit. Ata u ankuan se kompjuterët mbi tavolinë i pengonin të ndiqnin folësin në seancë, dhe se ishin të shqetësuar që ekrani i madh mund të monitorohej qoftë nga kolegët pas tyre, qoftë nga kamerat e televizioneve, që në seancë rrinë në lozhën mbi sallën e seancave.

FOTO LAJM

TAKIMI RAMA-HARADINAJ

Kandidati për kryeministër të Kosovës, Ramush Haradinaj është takuar me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama në Dhërmi. Këtë e ka bërë të ditur gruaja e Ramush Haradinajt, Anita Muçaj-Haradinaj përmes një postimi në "Instagram". "Sot me Edin në Dhërmi!! Kryeministri i shqiptarëve", ka shkruar ajo në "Instagram".

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së analizon situatën në vend

Petrit Vasili: Bilanc lufte, Edi Rama një turist me pushime

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

IRONIA ME RAMËN

"S'na mbetet gjë tjetër veçse t'i urojmë pushime të mbara. Ç'lidhje ka ai në fund të fundit me këtë vend? Turist është. Iku dikur, erdhi, do iki prapë, dhe hallet akoma më të mëdha do t'ua lërë shqiptarëve pa u zgjidhur asnjëren. Të tjerat... do t'i marrë me vete", e mbylli komentin e tij Vasili, duke ironizuar kryeministrin.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili analizoi dje, situatën e krijuar në vend me zjarret dhe mbytjet e disa qytetarëve në zonat bregdetare. Në një status të tij në rrjetin social "Facebook", Vasili e quan kryeministrin Edi Rama "një turist" dhe i uroi pushime të mbara. "Flakë në kodrat e Ardenicës. Një 13-vjeçar humb jetën duke u mbytur në Velipojë pak çaste më parë. Vera më e rëndë për shqiptarët. Bilanc i rëndë lufte: tragjedia e të mbyturve në plazhet shqiptare nuk ka të sosur dhe zjarret po shkretojnë vendin dhe pasuritë e qytetarëve. Të gjithë qytetarët janë në ankth dhe dëshpërim të thellë për vendin. Vetëm kryeministri është i qetë dhe i pashqetësuar hiç në romantizmin e tij veror dhe nuk shpenzon asnjë fjalë, as për qokë, e jo më për drejtim shteti", shkroi dje, në rrjetin social "FB", kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. "S'na mbetet gjë tjetër veçse t'i urojmë pushime të mbara. Ç'lidhje ka ai në fund të fundit me këtë vend? Turist është. Iku dikur, erdhi, do iki prapë, dhe hallet akoma më të mëdha do t'ua lërë shqiptarëve pa u zgjidhur asnjëren. Të tjerat... do t'i marrë me vete", e mbylli komentin e tij, Vasili. Një ditë më parë, Presidenti i Republikës Ilir Meta thirri në një takim ministrin e Brendshëm Dritan Demiraj, nga i cili është informuar për situatën e krijuar në vend. Por pati një reagim nga drejtuesi tjetër i LSI-së, Luan Rama, i cili i sugjeroi presidentit që, nëse nuk ishte informuar për atë se çfarë kishte ndodhur në vend nga Demiraj, ta thërriste përsëri, jo vetëm atë, por edhe kryeprokurorin Adriatik Llalla dhe drejtorin e SHISH-it. Duke komentuar takimin e ministrit të Brendshëm Demiraj me presidentin Ilir Meta, Luan Rama pyet nëse kreut të shtetit i është dorëzuar lista me 124 emrat e shpallur si kriminelë. "Duhet të thërrasë edhe Prokurorin e Përgjithshëm, edhe drejtorin e SHISH-it, edhe kryeministrin, sepse lufta kundër drogës duhet kthyer në një aksion kombëtar. Kjo është një luftë që duhet fituar medoemos, për të shpëtuar Shqipërinë!", thotë Luan Rama.

Ish-kryeministri akuzon pasardhësin se shtoi me 1250 herë sipërfaqet me kanabis

Berisha: Rama, piktor dështak, i varur nga droga dhe atletet

"Ai u përzu nga fotoja familjare në Podgoricë"

Ish-kryeministri Sali Berisha

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje, kryeministrin Edi Rama se rriti me shpejtësi, me 1250 herë sipërfaqen e mbjellë me kanabis në vend. Sipas Berishës, kryeministri Rama është i varur nga droga dhe atletet. Në një analizë të publikuar në profilin e tij zyrtar, Berisha shkroi dje: "Edi Rama, piktori dështak, mbylli mandatin e parë duke u bërë vërtet i famshëm, por realisht famëzi për narko-shtetin që ndërtoi këto vite në Shqipëri, duke merituar universalisht etiketimin e tij nga mediat më serioze të botës si 'Noriega i Europës'. E vërteta është se për Ramën, përdorues dhe addict droge, kjo e fundit nuk është dhe nuk mund të jetë krim por super vlerë". "Prandaj, - shtoi Berisha, - ai me shpejtësi rriti me 1250 herë sipërfaqen e mbjellë me kanabis në vend. Ngjiti Shqipërinë në vendin e dytë në botë në konsumin e kokainës dhe e shndërroi atë në portën kryesore të vërshimit të heroinës drejt Europës". "Por, - vijoi më tej ish-kryeministri, - Rama është bërë vërtet i famshëm në Europë dhe në botë për përdhosjen e protokollit të takimeve dhe samiteve ndërkombëtare me atletet e familjare bëhen fiks menjëherë në fundin e punimeve të samitit dhe zgjasin maksimumi 4-5 minuta. Nga ana tjetër, Podgorica është gjithsej 2.5 orë nga Tirana me makinë me eskortë. Mirëpo, pavarësisht nga avokatëtdhe atletelëpirësit e Ramës, ky i fundit e ndjen thellë përçmimin që i bëhet në këto samite. Ky përçmim kulmoi pas ndalimit të tij për të marrë pjesë në foton familjare të samitit me raportimin e 'New York Times' për këtë samit", tha Berisha. "Kështu, kjo gazetë sot, pasi njoftoi zhvillimin e punimeve të Samitit të Podgoricës, samit shumë i rëndësishëm për rajonin, pjesëmarrjen dhe takimet e zëvendëspresidentit të SHBA-ve në këtë samit me pjesëmarrësit e tjerë, për Edi Ramën shkruan vetëm se: 'Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, 53 vjeç, ish-artist dhe lojtar basketbolli, u shfaq në takimin e nivelit të lartë me atlete të bardha'. Me të drejtë mund të lindë pyetja se, pse Rama e bën veten lolo me atletet e tij në samitet ndërkombëtare?", u shpreh ish-kryeministri. Sipas Berishës, "e vërteta është se Rama, i ngërthyer nga sindromi i fetishit të atleteve, është bërë addict (i varur) ndaj tyre". tij të bardha". "Protokolli zyrtar, si etiketë shekullore e veprimtarive politike, bilaterale dhe multilaterale ka gjithnjë momentet zyrtare, në të cilat pjesëmarrësit, në respekt të njëri-tjetrit dhe të aktivitetit, detyrohen të paraqiten me një veshje zyrtare, dhe momentet e kohës së lirë në të cilat pjesëmarrësit mund të vishen dhe madje edhe ftohen nga mikpritësi që të vishen kazhual. Edi Rama, duke u vlerësuar nga mediat më serioze në Europë si lideri më pak i rëndësishëm i kontinentit, i kompleksuar keq, zgjodhi atletet për t'u bërë i 'rëndësishëm', të paktën qesharak", shkroi Berisha, duke komentuar paraqitjen e kreut të qeverisë në samitin e Podgoricës. "Për shkak të atleteve, ai u përzu nga fotoja familjare në Podgoricë dhe mashtroi shqiptarët duke u thënë se u largua me shpejtësi për në aeroport sepse helikopteri i tij nuk fluturonte natën, paçka se fotot

Deputeti i PD jep alarmin: Një aromë si e një kufome në dekompozim po vret Elbasanin

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi denoncoi dje, faktin që sipas tij në Elbasan është përhapur një aromë që ai e krahason me të një kufome në dekompozim, e cila siç thotë ai "po vret". "Prej ditësh, krahas tymit të zjarreve që shpresojmë të mos rikthehen më në Elbasan, që nga mëngjesi deri në darkë, shpërhapet një aromë qelbëse e padurueshme si e një kufome në dekompozim e sipër! Më shumë këtë e vuan pjesa jugore dhe ajo jugperëndimore e qytetit, por sidomos lagjet 'Skënderbej' dhe 'Katundi i ri'. Është aroma e tymit që vjell inceneratori ankthndjellës i qytetit. Krahasuar me aromën e dikurshme të gropës afër Shkumbinit, kjo e dikurshmja duket si kujtim i një parfumi", e paraqet situatën deputeti i PD-së.

DEPUTETI I PD-së

Rritja e çmimit të ujit në Durrës, Bylykbashi: Vangjush Dako, sharlatan

Deputeti demokrat i Durrësit, Oerd Bylykbashi akuzoi kryetarin e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako për rritjen e çmimit të ujit në këtë qytet. Sipas Bylykbashit, ligjërisht çmimi nuk është rritur, por këtë e kërkoi vetë Dako. "U zgjova sot në mëngjes me dy lajme. I pari, ?që nuk kishte ujë në rubinet, dhe lajm më të keq nuk ke në mes të vapës së verës. I dyti, që Dako paska ngritur çmimin e ujit për durrsakët sipas modelit sharlatan të kryekryebashkiakut", - u shpreh dje, Bylykbashi. E duke kujtuar fëmijërinë e tij kur i duhej të mbushte ujë te komshiu, ai thotë se asgjë nuk ka ndryshuar as në 2017-ën. "Po kjo puna e çmimit?! Këshilli Bashkiak i Durrësit e ka rrëzuar para pak muajsh rritjen e çmimit. Dako kërkoi ta rriste për herë të dytë brenda një viti, por opozita nuk e lejoi. Pra nga enti pronar i UKD, Bashkia Durrës, nuk ka asnjë autorizim për rritjen e çmimit dhe asnjë dëgjesë publike, siç kërkohet nga ligji, nuk ka. Në faqen e internetit të ERRU (Enti Rregullator i Ujit) nuk ka asnjë vendim për rritje çmimi", - sqaron Bylykbashi. Dhe me ironi më pas ai thotë: "Dhe ajo që të mahnit fare është fakti që ata nuk bzajnë fare. Fare! Delet kur duan ujë bëjnë beee. Po ne jemi qytetare, nuk ndihemi, nuk bëjmë zhurmë. Jemi qytetërim 2700-vjeçar, ne. Të ndëshkojmë me heshtjen tonë vrasëse! Nuk e ulim veten ne të bzajmë, le më të protestojmë! Ja, as tironcit nuk bzajtën hiç kur ua rriti çmimin e ujit apo të biletës së autobusit Dako i tyre. Vazhdojmë me shpresën (absurde) që kur të kemi më shumë ujë do të ulet çmimi, sepse kur nuk paska ujë çmimi u rritka!" - u shpreh deputeti i PD-së.

Njoftim

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

" Apartament me sip 48 m2 me nr pasurie 1/532+2-14 , Volumi 4 , Faqe 27 , ZK 8592 , me adrese :V Kushi , Rruga :R Tyli ,Pallati 888 ,Shkalla e 3 , kati i 5 ,Apart 14 Shkoder

Cmimi fillestare per shitjen ne ankand eshte ne masen 1,108,800 (Njemilione e njeqind e tetemije e teteqind) leke .

Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date **07.08.2017** ora **16.16** ne **Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati** me adrese Rruga Don Bosko, Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie **41064051**, ose ne Tirana Bank me nr IBAN **AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100** .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 09.08.2017 ne oren **16.00** ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit **Are+Truall+Shtepi Banimi**" me sipërfaqe totale **2000 m²** nga e cila truall **500 m²** nga kjo ndertese 3 kateshe me siperfaqe totale **544 m²** , e regjistruar ne regjistrin hipotekor me nr. date ,me volum 4, faqe 3, numer pasurie 34/44, ne zonen kadastrale 1934, me adrese Hasan (Kruje).Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren **10,400,000 (dhjete milion e katerqind mije) lekë**.

Policia: 41-vjeçari, person me precedent penalë dhe në Greqi, Belgjikë dhe Itali

Grabiste me armë me selenciator karburante e argjendari, kapet i tmerrshmi nga Berati

Aleks Prifti kreu 7 bastisje në 3 ditë në disa qytete



41-vjeçari, Aleks Prifti

Një nga argjendaritë e grabitura nga Prifti

TIRANE

Një 41-vjeçar nga Ura Vajgurore e Beratit, i cili ishte kthyer në tmerrin e pikave të karburantit dhe të argjendarive në disa qytete të ndryshme të vendit është arrestuar mbrëmjen e së premtes nga Policia e Shtetit. Bëhet fjalë për Aleks Priftin, i cili konsiderohet person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi vetëm brenda tre ditëve kishte kryer 7 grabitje. Ai u prangos gjatë operacionit të koduar "Fuel thieves" që u zhvillua në Durrës. Burime zyrtare nga policia dje deklaruan se 41-vjeçari është i njohur si person me precedent të mëparshëm kriminale, për vjedhje, plagosje me armë të ftohta dhe armë zjarri e gjobë vënie. Gjithashtu, ky shtetas është person me precedent kriminal edhe në Greqi, Belgjikë e Itali.

OPERACIONI

Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda në bashkërendim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale dhe drejtoritë vendore të policisë në Durrës, Fier, Berat dhe Elbasan, organizuan dhe zhvilluan operacionin për zbulimin dhe dokumentimin ligjor të aktivitetit kriminal të një shtetasi me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Mësohet se ai lëvizte me një automjet tip "HONDA", të marrë me qira dhe nën kërcënimin e një arme zjarri pistoletë me silenciator, kryente "Vjedhje me dhunë" dhe "Vjedhje me armë" kryesisht në pikat e karburantit në akset rrugore të këtyre qarqeve si dhe në dyqane bizhuterish, ku brenda 3 ditëve të fundit arriti të kryente 7 vjedhje më armë e dhunë. Pas një pune hetimore intensive dhe profesionale, duke përdorur të gjitha mjetet dhe metodat teknikoshkencore për të vërtetuar veprimtarinë e tij kriminale, të kryer nga Komisariati i Policisë Lushnje, Kavajë dhe Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit, u bë i mundur identifikimi dhe vendndodhja e personit të dyshuar si autor i këtyre ngjarjeve. Sipas burimeve nga Policia e Shtetit, gjatë datave: 1, 2, 3 dhe 4 gusht 2017, Aleks Prifti ka kryer 7 vjedhje me armë dhe dhunë në disa pika karburantesh në qytete të ndryshme të Shqipërisë si edhe ka tentuar të vjedhë me armë një argjendari në qytetin e Lushnjës. Nga hetimet e kryera rezultoi se autori i këtyre veprave penale, në momentin e kryerjes së grabitjeve, targat e automjetit i mbulonte me shirit natriban me qëllim që të mos identifikohej para këtyre subjekteve. Gjithashtu, më datën 26 qershor 2017 në Berat, ky shtetas së bashku me vëllain e tij kërcënojnë për marrje pasurie një shtetas, (vepër për të cilën vëllai është arrestuar, ndërsa ky shtetas u shpall në kërkim). Kapja e 41-vjeçarit është bërë mbrëmjen e djeshme (të premtes) në Durrës dhe më pas është transportuar për në Lushnje ku dhe janë kryer veprimet për arrestimin e tij. Në bashkëpunim me prokurorinë po punohet për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale të këtij shtetasi. Njëkohësisht po vijon puna në bashkëpunim me partnerët tanë në Itali, Belgjikë e Greqi për të dokumentuar veprimtarinë kriminale të këtij personi.

GRABITJET E KRYERA NGA ALEKS PRIFTI

1. Në datën 01.08.2017, rreth orës 22:00, në fshatin Portës, Fier, nën kërcënimin e armës ka vjedhur paratë e xhiros ditore në një pikë karburanti.
2. Në datën 02.08.2017, rreth orës 14:18, ka kryer vjedhjen me armë (pistoletë) të mbetur në tentativë të një argjendarie në qytetin e Lushnjës.
3. Në datën 02.08.2017, nën kërcënimin e një arme (pistoletë) ka tentuar të vjedhë një pikë karburanti në qytetin e Cërrikut.
4. Në datën 03.08.2017, rreth orës 22:15, ka kryer vjedhje me armë (pistoletë) të një pike karburanti në Maminas, Durrës.
5. Në datën 04.08.2017, rreth orës 05:08 në fshatin Bardhas, Peqin, nën kërcënimin e armës ka vjedhur paratë e xhiros ditore në një pikë karburanti.
6. Në datën 04.08.2017, rreth orës 05:12, në fshatin Karinë, Peqin, nën kërcënimin e armës ka vjedhur paratë e xhiros ditore në një pikë karburanti.
7. Në datën 04.08.2017, në orën 05:25, në Rrogozhinë, ka vjedhur me dhunë nën kërcënimin e një arme, një tjetër pikë karburanti.

Ndjekje e çmendur në Parma, arrestohet një nga Skifterët" shqiptarë, dy të tjerë në kërkim

ITALI - Policia e Parmës është përfshirë në një ndjekje të çmendur gjatë natës të së premtes, ndërsa shënjestër kishte një automjet ku udhëtonin tre shqiptarë, të njohur si grabitës serialë në zonën e Correggios. Madje për të çuar në fund detyrën e tyre, policëve iu është dashur të përplasin makinën e tyre me një "BMW" të vjedhur nga shqiptarët qershorin e kaluar, siç raporton "Gazetta di Parma". Nga përplasja mësohet të jenë lënduar edhe dy prej efektivëve të policisë. Por, me sa duket edhe kjo metodë nuk ka rezultuar efektive, pasi siç raportohet, dy prej "skifterëve" ia kanë mbathur me vrap nëpër fshatin përbri rrugës. Policia e Parmës ka arritur të arrestojë vetëm një prej hajdutëve, 32-vjeçarin Bardhok Lleshaj. Megjithatë thuhet se blutë e Parmës i kanë identifikuar tashëm dy skifterët që shpëtuan gjatë natës dhe kapja e tyre është thjesht çështje kohe.

> Për të çuar në fund detyrën e tyre, policëve iu është dashur të përplasin makinën e tyre me një "BMW" të vjedhur nga shqiptarët qershorin e kaluar

SHKURT

Qëlloi me grusht policin, bie në pranga vlonjati

SARANDË - Një 44-vjeçar nga Vlora është arrestuar nga Policia e Sarandës, pasi ka dhunuar një polic gjatë ushtrimit të detyrës. Ngjarja ka ndodhur në një plazh publik, ndërsa në pranga ka përfunduar shtetasi Ismail S., 44 vjeç, banues në Vlorë. Mësohet se ky i fundit, së bashku me kunatin e tij D.Z., kanë qenë duke bërë sherr me një tjetër shtetas, F.P.. Në momentin që polici ka ndërhyrë për të shuar sherrin, vlonjati e ka goditur me grusht. Policia ka bërë arrestimin e Ismail S., pasi ka kundërshtuar dhe ka ushtruar dhunë fizike ndaj punonjësit të policisë. Materialet u referuan në Prokurori ndaj tij për veprën penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik".

Përdhunonin fëmijët, arrestohen 2 shqiptarë

GREQI - Dy shtetas shqiptarë janë arrestuar në Greqi, si pjesë e një bande të rrezikshme që merrej me joshjen dhe përdhunimin e fëmijëve të vegjël. Lajmi bëhet i ditur nga mediat greke, ndërsa edhe policia ka shpërndarë një deklaratë për këtë rast, siç raporton për Balkanweb gazetarja Shpresa Dine. Dy shqiptarët, njëri 36 dhe tjetri 31 vjeç u kapën pasditen e djeshme në Janinë. Identitetet e tyre janë mbajtur të fshehura nga policia greke për arsye hetimi. Ata janë pjesë e një dosje me shumë materiale që i kompromenton për veprat e rënda penale, të përdhunimit dhe joshjes së fëmijëve. Policia dyshon se janë marrë edhe me trafik droge.

Mbytet në Velipojë 13-vjeçari nga Kosova

SHKODËR - Një tjetër ngjarje e rëndë në bregdetet shqiptare. Një 13-vjeçar është mbytur pasditen e djeshme në Velipojë. Sipas policisë viktima është minoreni me inicialet L.I. nga Mitrovica Kosovë. Mësohet se djali ndodhej bashkë me familjen në plazh, ku kishin shkuar për të kaluar fundjavën. Ai është futur për t'u larë në det, por nuk ka mundur të dalë i gjallë. Pushues të tjerë e kanë nxjerrë trupin e tij në breg duke u përpjekur ta sjellin në jetë, por ka qenë e kotë. Sipas bluve, ekipi mjekësor dhe policia kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje, por fëmija ka ndërruar jetë. Po kryhen veprimet me grup hetimor për sqarimin e plotë të rrethanave të plota të kësaj ngjarjeje. Gjatë sezonit verior të këtij viti janë mbytur në det një numër i konsiderueshëm personash.

Autori djeg automjetin, dyshohet për një atentat

Terror në qendër të Elbasanit, qëllohet me breshëri automatiku nga një makinë tip "BMW"

ELBASAN - Një person ende i paidentifikuar ka terrorizuar dje banorët e qytetit të Elbasanit, pasi ka qëlluar me armë zjarri në ajër teksa po lëvizte me një automjet tip "BMW". Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku bënë me dije se ngjarja ka ndodhur paraditen e djeshme, rreth orës 09:00, në lagjen "Emin Matraxhiu", në afërsi të "Urës së Bakallit". Mësohet se krismat e armës kanë shkaktuar panik te kalimtarët. Sipas bluve, pasi është qëlluar me breshëri kallashnikovi, automjeti është larguar me shpejtësi. Fatmirësisht nga të shtënat nuk ka pasur persona të lënduar. Menjëherë në vendngjarje mbërriti policia, e cila nisi hetimet. Burimet e mësipërme pohuan se mjeti në fjalë u gjet i djegur në lagjen "Haxhias" të këtij qyteti. Nga verifikimet paraprake, makina tip "BMW" rezulton në pronësi të shtetasit B.B.. Ndërkaq, burime pranë grupit hetimor pohuan se mjeti përdorte targa false. Sipas hetuesve të çështjes, ka dyshime të forta që ky person ka pasur si qëllim të ekzekutojë dikë. Policia, gjithashtu sqaroi se nuk ka gjetur gëzhoja në vendngjarje, ndonëse janë dëgjuar disa të shtëna. Blutë e Elbasanit kanë sekuestruar sakaq pamjet filmike të kryqëzimit të rrugëve ku është qëlluar me armë nga "BMW"-ja dhe është vënë në gjurmët e personit që ka qëlluar me armë. Sipas të njëjtave burime, mbërritja në kohë e zjarrfikëses ka bërë të mundur evitimin e djegies së menjëhershme të mjetit "BMW", çka mund t'i shërbejë policisë për të mbledhur prova. Policia dhe prokuroria e Elbasanit po hetojnë intensivisht për zbardhjen e kësaj ngjarjeje si dhe identifikimin e vënien në pranga të autorit.

Kapiteni i Përgjithshëm i Porteve: Vendi i pezullimit jepet nga gjykata

Shkeli ligjet ndërkombëtare, trageti "Bridge" lejohet të lundrojë sërish

Policia: S'kemi raportin përfundimtar nga Drejtoria Detare

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Vijon të thellohet edhe më shumë skandali me tragetin "Bridge", i cili, në shkelje të hapur të ligjeve ndërkombëtare të lundrimit, me defekt të rëndë në motor, udhëtoi 36 orë nga Ankona në Durrës me 806 pasagjerë një javë më parë (të dielën që shkoi). Pavarësisht hetimit të nisur ndaj kapitenit të tragetit të kompanisë detare "Adria Ferries", atij iu dha leja e lundrimit nga Kapiteneria e Portit të Durrësit të nisej mbrëmjen e së enjtes nga ky port drejt Ankonës. Ndërkaq, përfaqësues të Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve pohuan se hetimi nuk po kryhet siç duhet, madje po pengohet qëllimisht zbardhja e së vërtetës. Sipas kapitenit të Përgjithshëm të Porteve, Paulin Ndreu, në asnjë vend të botës nuk do të lejohej nga asnjë autoritet që kapiteni i një anijeje të mbushur me pasagjerë që shkel ligjet ndërkombëtare të lundrimit të lihej i lirë, e madje të mos merrej asnjë masë paraprake ndaj tij, pronarëve e as ndaj agjencisë së lundrimit. Mësohet se pasagjerët që mbetën në mes të detit javën e shkuar i shkruan kryeministrit duke e vënë në dijeni për situatën, ndërsa asnjë institucion nuk kishte dijeni se çfarë po ndodhte në det, pasi kapiteni i anijes "Bridge" nuk i kishte lajmëruar institucionet.

Kapiteni i Përgjithshëm i Porteve, Paulin Ndreu

HETIMI

Policia dhe prokuroria e Durrësit kanë nisur një hetim intensiv, pasi kreu i qeverisë, Edi Rama ka urdhëruar që policia ta hetojë çështjen me precedencë. Kryeministri ishte lajmëruar nga pasagjerët se trageti ishte i palicencuar dhe me precedentë të rëndë në lundrim. Burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar dje bënë me dije se hetimi ka filluar ndaj kapitenit të tragetit, kompanisë dhe agjencisë, për mosnjoftim të defektit. Hetuesit e çështjes kanë marrë në pyetje kapitenin e tragetit, ekuipazhin dhe kanë zbarkuar në zyrat e agjencisë së lundrimit. Para nisjes së tragetit, inspektorët e antikrimit ekonomik kanë zbarkuar në port dhe kanë sekuestruar dokumentacionin e anijes për të zhvilluar hetimin. Kopjet e dokumentacionit të tragetit, prej licencës së tij të miratuar nga Ministria e Transporteve e që mban datën 14 korrik 2017; lejet e lundrimit; të gjendjes teknike të klasifikimit; siguracionit etj., janë objekt i hetimit edhe nga strukturat e tjera. Njëkohësisht, hetime po kryen edhe nga Drejtoria Detare, e cila ende nuk i ka dorëzuar një raport përfundimtar policisë për çështjen e tragetit.

KAPITENERIA

Kapiteni i Përgjithshëm i Porteve, Paulin Ndreu dje deklaroi se çështja është në hetim dhe ka kohëzgjatje të madhe deri në raportin përfundimtar. Ai tha se "Kapiteneria si institucion nuk mund të bllokojë lundrimin e anijes në fjalë pa vendim gjykate dhe pa raport të detajuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, ndërkohë që është Ministria e Transporteve ajo e cila ka bërë licencimin e mjeteve lundruese. Kjo ministri, në bazë të performancës së tragetit, i heq ose i rinovon licencën tragetit. Mjeti lundrues është me flamur të huaj dhe institucioni që unë përfaqësoj nuk ka asnjë kompetencë të bllokojë lundrimin, pavarësisht shkeljeve flagrante që ka kryer. Vendimin e merr vetëm gjykata e Durrësit".

AKUZA

Kapiteni i Përgjithshëm i Porteve, Paulin Ndreu deklaroi për "GSH" se Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk po lejon investigimin përfundimtar nga kontrolli shtetëror portual, duke zvarritur konkluzionet përfundimtare të çështjes, të cilat do të bënin të mundur edhe daljen para përgjegjësisë direkte të personave.

SHKURT

U fiket motori i skafit, Policia shpëton 4 të rinj

VLORË - Një ngjarje e rëndë është arritur të shmanget në Vlorë. Mësohet se një skaf ka rrezikuar të mbytet në Karaburun. Kanë qenë 4 persona që udhëtonin në bordin e skafit, por për shkak të një defekti në motor, mjeti është fikur dhe ka rrezikuar të mbytet. Më pas personat kanë telefonuar policinë Kufitare për defektin. "Ju lutem na ndihmoni, kemi ngelur në mes të detit me skaf. Ka defekt në motor", u janë drejtuar kufitarëve, katër të rinjtë. Menjëherë policia Kufitare u shkoi në ndihmë, duke rimorkiuar skafin e duke shmangur kështu një tragjedi. Mjeti ujor është nxjerrë më pas nga policia Kufitare në bregdetin e Radhimës.

Lufta me zjarret, plagoset një efektiv i FA-ve

TIRANË - Gjatë operacionit për shuarjen e zjarrit në malin e Derjes në Shën Gjergj të Tiranës, ka mbetur i lënduar në këmbë një nënoficer i batalionit special, tetar Skënder Hidri. Menjëherë efektivi i FA-ve u dërgua për ndihmë mjekësore në spital, ku gjendja e tij shëndetësore paraqitet e qëndrueshme. Ministria e Mbrojtjes njoftoi dje, se për shuarjen e zjarrit në malin e Derjes në Tiranë janë angazhuar rreth 50 efektivë të Forcave të Armatosura. Javët e fundit, efektivët e Forcave të Armatosura janë angazhuar në disa operacione nga veriu në jug të vendit për të shuar zjarret që kanë përfshirë Shqipërinë nga temperaturat e larta, por edhe rastet kur zjarrvënësit janë të qëllimshme.

Albanian-American Development Foundation

REQUEST FOR TENDERS (RFT) # 0127

The Albanian-American Development Foundation (AADF) began operations in November of 2010 with the support and encouragement of USAID and the United States Government. The foundation's mission is to make a meaningful contribution to Albania's economic growth by making social investments related to entrepreneurship, education, leadership development and support for cultural tourism.

AADF is enriching its Entrepreneurship and Cultural Heritage programs' portfolio with a new exciting project consisting of urban requalification and business development programme near Vlora city center, including restoration of cultural monuments' buildings, reconstruction of other buildings and creation of TID association. The project aims to create a unique model of management of the site and to integrate the public and private interests of the area into one structure.

Subject of The Tender: Restoration and reconstruction of façades and roofs of 68 buildings in the city of Vlora.

To receive a copy of the application package and other tender documents, please download from the links provided to you after registration on our website. If you have questions please address them only in writing by email to **tenders@aadf.org.**

The deadline for submitting bids is **Aug 21st, 2017** at **10:30** hours am.

I gjenden drogë dhe municione luftarake në banesë, përfundon në pranga 41-vjeçari

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka finalizuar operacionin e koduar "Nicaj" dhe ka arrestuar një person të rrezikshëm, në shtëpinë e të cilit ka gjetur një arsenal armësh e municionesh si dhe lëndë narkotike. Në pranga ra "i forti" Vat Lami, 41 vjeç, banues në fshatin Nicaj, Njësia Administrative Shosh në Shkodër. Gjatë kontrollit të ushtruar

Droga e sekuestruar në Shkodër

nga blutë, në banesën e Lamit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 5 kg e 258 gr. lëndë kanabis sativa e futur në një thes, 600 gr. lëndë e dyshuar eksplozive, 3 fitila zjarr përcjellës, 3 kapsolla detonatorë, 1 granatë dore me gjithë ndezës, 1 armë zjarri pushkë dhe 10 fishekë të kalibrit 7.62 mm. Materialet procedurale në ngarkim të 41-vjeçarit i kaluan prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprat penale" të "Prodhimit e shitjes së narkotikëve" "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit". Pritet që Gjykata e Shkallës së Parë e Parë e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj tij.

Policia: Trafikantët janë duke eksperimentuar pa sukses rrugë alternative

Superoperacioni në det të hapur, skafistët shqiptarë po transportonin 2.5 ton drogë

Gomonia u ndoq për 5 orë në ujerat e Adriatikut

TIRANË

Policia e Shtetit ka dhënë detaje të reja në lidhje me super operacionin antidrogë që u realizua mbrëmjen e së premtes në bashkëpunim me autoritetet italiane dhe ato të Malit të Zi, ku u arrestuan dy trafikantë shqiptarë që tentonin të transportonin marijuanë me skaf. Mësohet se sasia e lëndës narkotike që u kap nga policia italiane në det është 2.5 ton. Mësohet se dy trafikantët sapo kanë parë se ishin në ndjekje nga policia e vendit fqinj kanë hedhur thasët me drogë në det. Bëhet me dije se në fund të operacionit, që zgjati 5 orë (ndjekje në det të hapur) policia e vendit fqinj bllokoi gomonen e fuqisë së lartë. Droga është mbledhur në det dhe është cuar më pas në rajonin e Foggias në Itali. Fillimisht pranë skafit, policia ka gjetur 2 ton drogë, ndërkohë që më pas janë gjetur edhe 13 pako të tjera me peshë 500 kg.

Droga e sekuestruar në det u dërgua në rajonin e Foggias

OPERACIONI ANTIDROGË

Pas operacionit antidrogë që u realizua në bashkëpunim mes tre shteteve fqinje, Policia e Shtetit deklaroi se zyrtarisht se trafikantët janë duke eksperimentuar, por pa sukses rrugë alternative për shkak të vështirësisë së hasur në ujërat shqiptare ku operojnë forcat e policisë së kufirit dhe të Guardia di Finanza të Nuklit të Kufirit Detar të Durrësit dhe Vlorës. Sipas këtyre burimeve, informacionet kalojnë në kohë reale nga Italia, Shqipëria dhe Mali i Zi duke krijuar një rrjetë të pakalueshme për trafikantët. Ndjekja e gjatë prej pothuaj 5 orësh, bëri të mundur bllokimin e gomones së fuqisë së lartë me tre motorë. Dy trafikantët u ndaluan në det të hapur nga Guardia di Finanza e Termolit dhe Barit të drejtuar nga avioni i Frontex. Forcat e policisë së kufirit të Shqipërisë me koordinimin e QNOD, NUFROM i Guardia di Finanza në Durrës dhe Vlorë dhe policia e kufirit të Malit të Zi kishin dalë në afërsi të kufirit Shqipëri-Mali i Zi ku edhe ishte drejtuar gomonia, pasi i ishte afruar njëherë bregdetit të Termolit në Molizë nga ku edhe ka filluar ndjekja. Gjatë ndjekjes, trafikantët kanë hedhur në det ngarkesën duke e bërë më të vështirë ndjekjen. Dy skafistët e arrestuar, (sipas mediave italiane), nuk janë me precedent penal dhe deri më tani kanë refuzuar të japin informacion për bashkëpunëtorët. Mediat italiane e konsiderojnë prej kohësh hapësirën detare mes Shqipërisë dhe Italisë, si "autostrada detare e drogës". Sa i përket trafikut të drogës nga Shqipëria, mediat e vendit fqinjë kanë publikuar dhe disa detaje hetimore. Bëhet fjalë për një letër me kontakte dhe listë importi të drogës nga Shqipëria dhe Brindizi. Letra është përpiluar nga 3 shtetas italianë që janë arrestuar ditë më parë. Mësohet nga "Brinidizreport" se ata janë në konkurrencë për trafikun e drogës me një bandë shqiptare që drejtohet nga Besmir Hameti, i cili gjendet në burg që prej 11 janarit. Në atë kohë ai u arrestua në bordin e një gomone me 1.9 ton marijuanë.

DETAJET HETIMORE

Sa i përket trafikut të drogës nga Shqipëria, mediat e vendit fqinjë kanë publikuar dhe disa detaje hetimore. Bëhet fjalë për një letër me kontakte dhe listë importi të drogës nga Shqipëria dhe Brindizi. Letra është përpiluar nga 3 shtetas italianë që janë arrestuar ditë më parë. Mësohet nga "Brinidizreport" se ata janë në konkurrencë për trafikun e drogës me një bandë shqiptare që drejtohet nga Besmir Hameti, i cili gjendet në burg që prej 11 janarit. Në atë kohë ai u arrestua në bordin e një gomone me 1.9 ton marijuanë.

Shkatërrohet banda e shqiptarëve nga Vlora, kapet kokainë dhe marijuanë

ITALI - Një sasi e konsiderueshme kokaine dhe marijuanë është sekuestruar nga policia italiane gjatë një operacioni antidrogë në Rimini. Katër shqiptarë janë arrestuar, të cilët shisnin drogën në bashkëpunim me njëritjetrin. Ata janë: B.L. 33 vjeç, H.S. 27 vjeç, M.E. 24 vjeç dhe I.G. 20 vjeç, të gjithë nga Vlora dhe pa precedent penal. Tre prej tyre janë emigrantë ilegalë, thotë policia italiane, kurse i katërti ka leje qëndrimi të lëshuar nga policia e Romës për arsye biznesi. Autoritetet thonë se do të kërkojnë revokimin

e lejes së tij të qëndrimit. Hetuesit kishin marrë informacion për bandën e shqiptarëve që qarkullonin shuma të mëdha parash nga shitja e drogës. Policia u vu në ndjekje të tyre dhe zbuluan se njëri nga shqiptarët kishte marrë me qira një garazh në bodrumin e një pallati. Aty fshihej kokaina dhe marijuana e trafikuar nga Shqipëria. Gjatë aksionit, policia bllokoi 1 kg kokainë, 4 kg marijuanë dhe 2300 Euro cash të përfituara nga shitja e drogës. Në garazh u gjet edhe një pistoletë lodër, për të cilën policia italiane thotë se është një kopje perfekte Beretta 92FS. Dy prej shqiptarëve u kapën në flagrancë në garazhin ku kishin fshehur lëndën narkotike, ndërsa dy të tjerët gjatë kontrolleve në banesë. Ata akuzohen për trafik dhe shitje droge.

Droga e sekuestruar në Këlcyrë

Sekuestrohen 107 kg kanabis, procedohet penalisht kryeplaku

Në momentet e lançimit, në statutin e Lidhjes së Shkrimtarëve, ishte vendosur vetëm një kusht për praninë në organizatë, i përcaktuar në nenin 4, ku thuhet: "**Nuk pranohen në këtë LIDHJE ata shkrimtarë, publicistë dhe gazetarë që i kanë shërbyer me veprat e tyre okupatorit, në mënyrë direkte dhe deri në fund tue u ba armiq të popullit**"(Revista "Bota e Re", nr. 1, 1945).

Përplasja ideore nisi organet e sapo krijuara, të cilat u shndërruan shumë shpejt jo thjeshtë në një "media" për përcjelljen dhe promovimin e arritjeve letrare, por në një arenë dhe më pas në një armë ideologjike.

Revista e parë "Bota e re" doli në korrik të vitit 1945, si vijim i "Bota e re", e Korçës, për të mbështetur "traditat pozitiviste dhe progresive të Rilindjes kombëtare" (Bota e Re, nr. 1); "me u ba pasqyrë e zhvillimit kultural", me përkrahur të "gjitha energjive mendore që e duan lirinë dhe përparimin", dhe për të "mbështetur talentet e reja"(Bota e Re, nr, 1). ...

→ Vijon në faqen 14

Redaktor: Ben Andoni; Grafika e numrit Adriana Matraku 296

NË KËTË NUMËR: Wislawa Szymborska, Albert Gjoka, Myzejen Shapllo, Jasna Shamiç etj...

MILONA

E diel 6 Gusht 2017 GAZETA SHQIPTARE

DOKUMENT

Ky dokument është ruajtur në arkivin personal të Dhimitër Shuteriqit, ish-kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, një nga drejtuesit kryesorë të grupit për kodifikimin e metodës së Realizmit Socialist në Shqipëri. Në vitin 2009, ky dokument bashkë me materiale të tjera janë dorëzuar në Arkivin Qendror të Shtetit. Dokumenti ka 13 faqe të shtypura me makinë shkrimi, me dialekt të theksuar toskë, dhe mban datën 13 korrik. Me shkrim dore është shënuar viti "1947". Po me shkrim dore është shkruar edhe autori i pretenduar i materialit, Behar Shtylla (Arkiva e PPSH, Dosja nr. 356), i diplomuar në Itali për letërsi, cili asokohe ka qenë zyrtar i lartë i Partisë Komuniste dhe më vonë ka punuar në fushën e diplomacisë, shpjegon autori...

Kur nisi udhën e saj letërsia e Realizmit Socialist në Shqipëri

Nga Albert Gjoka

Vijon nga faqja 13

... Drejtuesit e revistës, të cilët ishin njëherësh edhe drejtues të Lidhjes, e paralajmëruan misionin e vështirë për të qenë një shesh për zhvillimin lirisht të mendimit shqiptar si forcë reale e përparimit. Në të gjithë numrat e saj, por edhe në shkrimin hapës të Lame Kodrës, "*Roli i kulturës në Shqipërinë e sotme*", *shihet qartë se misioni i kësaj reviste i tejkalonte pasqyrimin e aktivitetit letrar në vend, por ishte një "shesh" kulturologjik dhe politik, dhe për rrjedhojë do ta mbyllte aktivitetin e saj shumë shpejt, duke ia lënë vendin revistës tjetër*; *"Literatura jonë", e cila e nxori numrin e parë në mars të vitit 1947, me staf të rinovuar, e fokusuar kryesisht te letërsia dhe me mision të ri, i cili do të "tribuna ku do të shtrohen problemet e literaturës s'onë, kritika letrare dhe sidomos nxitja për një prodhim letrar sa më të gjerë dhe sa më të mirë. Por sa i madh është problemi i të prodhuarit në fushën letrare aq është edhe ay i drejtimit letrar; i një drejtimi të ri i cili do të japë asaturën literaturës s'onë të nesërme*". Në këtë numër të revistës u botua jo rastësisht fjala e A. Fadejev "*Fjala e Shokut A. A. Zhdanov dhe detyrat t'ona më urgjente*" mbajtur më 2 tetor 1946 në Moskë përpara mbledhjes së shkrimtarëve sovjetikë. Edhe në numrin pasardhës u botua shkrimi "*Realizma Socialiste*" e L. Timofejev-it.

Edhe në numrat në vijim vijnë artikuj të Maksim Gorkit dhe autorëve të tjerë rusë, duke botuar gjithnjë e më pak nga autorë perëndimorë.

Një pjesë e mirë e autorëve shqiptarë që bashkëpunuan me "Bota e re" nuk shihen tek "Literatura jonë" me krijime apo artikuj kritikë. Kronikat për ngjarjet letrare flasin për një përafrim të madh me letërsinë dhe autorët rusë dhe instalimit gradual të letërsisë së realizimit socialist sipas praktikës ruse. Ky diskurs kulturologjik është sjellë i plotë edhe në librin "Semiopragmatika e realizimit socialist", me autor Ilir Yzeirin.

Viti 1947 shënoi momentin kritik të konfliktit mes "shkrimtarëve të pushkës" dhe "shkrimtarëve të mendjes", para se të finalizohej projekti që u aprovua në Konferencën e Tretë të Lidhjes së Shkrimtarëve që u mbajt më 9-12 tetor 1948. Këtë e dëshmon më së miri dokumenti që po paraqitet në këtë konferencë, me titull "Literatura shqiptare në periudhën e Luftës Naçional-Çlirimtare"(F. "Dhimitër Shuteriqi", Nr. 826, AQSH, Dosja Nr. 185).

NJË HISTORIK RRETH DOKUMENTIT

Ky dokument është ruajtur në arkivin personal të Dhimitër Shuteriqit, ish-kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, një nga drejtuesit kryesor të grupit për kodifikimin e metodës së realizimit socialist në Shqipëri. Në vitin 2009, ky dokument bashkë me materiale të tjera janë dorëzuar në Arkivin Qendror të Shtetit. Dokumenti ka 13 faqe të shtypura me makinë shkrimi, me dialekt të theksuar toskë, dhe mban datën 13 korrik. Me shkrim dore është shënuar viti "1947". Po me shkrim dore është shkruar edhe autori i pretenduar i materialit, Behar Shtylla (Arkiva e PPSH, Dosja nr. 356), i diplomuar në Itali për letërsi, cili asokohe ka qenë zyrtar i lartë i Partisë Komuniste dhe më vonë ka punuar në fushën e diplomacisë.

Në Arkivën Qendrore të Shtetit ky dokument është regjistruar pa datë të saktë. Behar Shtylla ka përfunduar tre vjet studimet për letërsi në Itali dhe ka punuar gjatë vitit 1941 në revistën "Shkëndija". Ky punim nuk synon të merret me autorësinë e materialit, por konstatohet lehtësisht se për përgatitjen e tij, bashkë me autorin e shfaqur, pra Behar Shtyllën, kanë bashkëpunuar edhe shkrimtarë, të cilët ishin pjesë e grupit nismëtar për instalimin e metodës socrealiste në Shqipëri.

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Materiali bën një skanim të plotë të gjendjes letrare në Shqipërinë së vitit 1947 dhe bën një klasifikim të grupeve, parë në një këndvështrim të fortë ideologjik. Këtu shfaqet koncepti i ri ideologjik për letërsinë: "*Edhe procesi letrar shkon paralel me procesin e përgjithshëm, është pjesë e tij e pandarë; edhe trathtarët kanë literaturën e tyre profashiste, populli në luftën kundër tyre krijon literaturën e tij të luftës antifashiste*" (F. "Dhimitër Shuteriqi", AQSH., Nr. 826, Dosja Nr. 185). Pra, këtu theksohet se "*literatura ësht literature klase*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Në këtë dokument bëhet klasifikim në shkrimtarë antifashistë dhe fashistë.

Grupi i dytë ndahet në: Shkrimtarët kriminelë lufte dhe Shkrimtarët e kompromisit. (*shih tabelën*). Ky klasifikim bëhet duke i konsideruar grupimet kulturore si organizime të cilët kanë një drejtues, kanë anëtarët dhe mbështetësit e tyre.

VENDOSJA E METODËS SË REALIZMIT SOCIALIST

Vendosja e metodës së realizimit socialist në Shqipëri nuk u bë e mundur përmes një procesi të mirëfilltë debatesh teorike apo ideologjike për një letërsi të angazhuar, - siç kishte ndodhur në shumë vende të Lindjes, apo siç kishte nisur në vitet '30; apo siç vijoi në vitet 1945-45 (përmes qëndrimeve të Sejfulla Malëshovës), - por përmes mekanizmave të imponimit ekstraletrar, përmes politikës së regjimit të ri. Këtë e dëshmon fakti se në krye të grupit të shkrimtarëve antifashistë u vendos Enver Hoxha, Nako Spiro dhe Qemal Stafa.



PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Materiali bën një skanim të plotë të gjendjes letrare në Shqipërinë së vitit 1947 dhe bën një klasifikim të grupeve, parë në një këndvështrim të fortë ideologjik. Këtu shfaqet koncepti i ri ideologjik për letërsinë: "*Edhe procesi letrar shkon paralel me procesin e përgjithshëm, është pjesë e tij e pandarë; edhe trathtarët kanë literaturën e tyre profashiste, populli në luftën kundër tyre krijon literaturën e tij të luftës antifashiste*" (F. "Dhimitër Shuteriqi", AQSH., Nr. 826, Dosja Nr. 185). Pra, këtu theksohet se "*literatura ësht literature klase*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Në këtë dokument bëhet klasifikim në shkrimtarë antifashistë dhe fashistë.

Grupi i dytë ndahet në: Shkrimtarët kriminelë lufte dhe Shkrimtarët e kompromisit.(*shih tabelën*). Ky klasifikim bëhet duke i konsideruar grupimet kulturore si organizime të cilët kanë një drejtues, kanë anëtarët dhe mbështetësit e tyre. Referuar dokumentit, shkrimtarët e pasluftës u klasifikuan si më poshtë:

KLASIFIKIMI I SHKRIMTARËVE *(sipas dokumentit)*
Grupi i shkrimtarëve fashistë
Grupi i shkrimtarëve antifashistë
Shkrimtarët kriminelë-lufte
Shkrimtarët e kompromisit
Shkrimtarët antifashistë

I. DREJTUESIT E GRUPEVE
Gjergj Fishta
Grupi i Ballit Kombëtar që drejtohej nga:
Lumo Skëndo
Mustafa Kruja
Pater Anton Harapi
Ernest Koloqi
Mithat Frashëri
Enver Hoxha
Nako Spiro
Qemal Stafa
Lazer Shantoja

II. ANËTARËT E GRUPEVE
(Grupi i "Neoshqiptarizma")
Vangjel Koça
Shefqet Musaraj
Shefqet Peçi
Nexhat Hakiu
Selaudin Tota
Zihni Sako
Lasgush Poradeci
Naxhije Duma
Fatmir Gjata
Mitrush Kuteli
Vedat Kokona
Nebil Çika
Memo Meta
Sterjo Spasse
Stefan Shundi
Aleks Çaçi
Pullumb Dishnica
Dashnor Mamaqi

III. MBËSHTETËSIT E GRUPEVE
Namik Resuli
Injac Zamputi
Musine Kokalari
Aleksandër
Bardhyl Pogoni
Hetem Haxhiademi
Nonda Bulka
Sotir Caci
Stavri Drenova
Ali Asllani

Siç shihet edhe nga tabela, për klasifikimin e shkrimtarëve është ndjekur një kriter ideologjik, ku në grupin "shkrimtarët fashistë" janë përfshirë shkrimtarët e konsideruar nacionalistët, ata që morën pjesë në qeverisjen fashiste dhe grupimi i intelektualëve të "neoshqiptarizmës". Në grupimin e tyre, tek "shkrimtarët e kompromisit" janë përfshirë ata që ishin afër kreut të Ballit Kombëtar, Lumo Skëndo dhe në grupin e tretë, te shkrimtarët antifashistë janë përfshirë të gjithë shkrimtarët që mbështetën luftën.

Sipas dokumentit, "*shkrimtarët që bien në prehrin e fashizmit, bëhen kasnecët e shërbëtorët e tij ose pajtohen me situatën e okupacionit dhe shkruajnë në këtë situatë, janë të gjithë njerës të lidhur në një mënyrë ose në tjetrën me klasën e bejlerëvet, të bajraktarëve, të tregtarëve e të priftërinjvet, në klasën që sonte në kohën e Turqisë, që sundonte në kohën e Zogut, që sondonte nën fashizmin, janë shkrimtarë të kapitalit e të pronës private, të fryrë me ndienja shoviniste për Shqipërinë e madhe kundër shkjaut, kundër grekut, me konceptin e hierarkisë së klasave e të elitës, së parisë që gëzon të gjitha privilegjet dhe sundon mi masat....*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185). Ndaj tyre dhe krijimtarisë letrare paralajmërohet qartë masa ekstreme,- zhdukja e tyre, - ashtu siç ndodhi në të vërtetë:

"Vepra e tyre. Prodhimi letrar i ketyre njerezve ne pjesen me te madhe ka pare drin perpara okupacionit dhe vlen te studjohet ne ate periudhe. Ne kohen e luftes Nacional Çlirimtare keta miren qe te gjithe aktivisht me politik ne favor te okupatorit, kunder popullit. Shkrimet e tyre te kohes kan karakter publicitar – demagogji e nxitje per lufte vella-vrasese, per lufte grabitqare kunder vendeve fqinje, glorifikojne okupacionin, meren me literature dhe politike fashiste, me literaturen italiane per te ngulur kulturen fashiste e italiane ne Shqiperi.

Vepra e tyre duhet zhdukur?" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Për grupin e "*shkrimtarëve të kompromisit*" thuhet: "*këta dallohen nga të parët për një aktivitet politik më pak të dukshëm. Vetëm kjo i ndan pse shtresa e tyre, shpirti dhe edukata e tyre i lidh me të parët*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Kundër grupit të shkrimtarëve profashistë vihen shkrimtarët anti-fashistë, si letërsia e re kundër së vjetrës, një letërsi që lindi dhe u zhvillua tok me luftën ndërsa vepra e tyre përfshinte "*fjalime, trakte dhe artikuj politik, gazeta, revista, broshura, vjersha, novella, drama*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Në fund të këtij dokumenti thuhet: "*Literatura e re ka t'ardhmen përpara. Ajo është e huaj kjo është e jona. Në periudhën e re të luftës për ndërtimin e socializmit shkrimtarët t'anë të mësojnë mi literaturën e luftës Nacional Çlirimtare e të perfeksionojnë artin e të shkruarit për popullint'onë në konditat e reja të luftës, në problemet dhe aspiratat e tij aktuale, mbi marrëdhëniet e reja politike, ekononomike e shoqërore të krijuara në Shqipëri*" (F. Dh. Shuteriqi", Dosja Nr. 185).

Ja sesi e argumentonte Dhimitër Shuteriqi qëndrimin e disa shkrimtarëve që u klasifikuan në të ashtuquajturin grupi i "shkrimtarëve fashistë": "Fishtën etj., i kemi gjetur si fashist e kolaboracionist më 1950 kur në tërë botën kishte raste të tilla (Erza Paundin e shëtitën në një kafaz hekuri, nëse e di saktë; Brazijakun e pushkatuan, dhe Celini nuk hyri dot në Francë për 2-3 dekada, por jetoi i mërguar, që di saktë); tek ne vepruan ndryshe, nuk i futën në tekstet shkollore, nuk i ribotuan...."(F. "Dhimitër Shuteriqi", Nr. 826, AQSH, Dosja Nr. 9). Ndërsa për Mitrush Kutelin shprehej: "Në Maj 1944, - gjente dhe ditën! Se me 1 maj!, - te Gazeta Letrare që botonte në Tiranë, Kuteli merrte nëpër gojë "shkrimtarët me kobure" që kishin vënë kokën në torbë kundër nazistëve. Ja budallëqe mbi budallëqe! Përse? Si guxonte? Shevqet Musaraj sapo botonte "Epopeja e Ballit Kombëtar". Tani jo K.(Kuteli, - shën. red.), po dhe kalamanjtë e shihnin se si po precipitonte falimenti nazist: si po guxonte K. të delte e të përgojonte "shkrimtarët me kobure" që luftonin nazizmin? K. duhej të besonte si dhe disa bashkëpunëtorë të gazetës në fjalë, se Lufta nuk do të mbaronte me fitoren e partizaneve, po me fitoren e Ballit që aleatët "pseudo" të komunistëve do t'i sillte në fuqi!" (F. "Dhimitër Shuteriqi", Nr. 826, AQSH, Dosja Nr. 9).

Duke iu referuar të gjithë burimeve të historisë së letërsisë shqipe të pasluftës, duket qartë se ky dokument vjen në një moment kritik të debateve mes grupeve të shkrimtarëve dhe artistëve për fatin e letërsisë dhe kulturës shqiptare pas çlirimit. Pikërisht në kohën kur nuk ishte vendosur ende kahja në të cilën do të zhvillohej kultura kombëtare shqiptare asokohe, dokumenti parapriu atë që do të ndodhte me gjithë procesin letrar dhe me fatin e shkrimtarëve në vitet në vijim.

DREJT LETËRSISË TOTALITARE

Konferenca e Tretë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipnisë, e zhvilluar më 9-12 tetor 1949, u shoqërua me debate të ashpra gjatë tre ditëve të zhvillimit të saj. Në të u përvijuan dy grupime: Mbështetësit e metodës realizimit socialist, të përfaqësuar nga Shefqet Musaraj, Dhimitër Shuteriqi, Mark Ndoja, Kol Jakova, dhe grupimi që kishte rezerva: Sejfulla Malëshova, Skënder Luarasi dhe Ymer Dishnica: Në diskutimet treditore PPSH kishte përfaqësuesin e saj, Bedri Spahiu, i cili hapi dhe mbylli debatet e kësaj konference.

Në finalizimin e konferenca sanksionoi "drejtimin që do të merrte letërsia shqipe, metodën e re të realizimit socialist sipas modelit sovjetik, riorganizoi Lidhjen dhe ndryshoi statutin që ishte miratuar në vitin 1945,"pastroi" e radhëve të saj, teksa u pozicionua ndaj traditës letrare dhe bërë seleksionimin e saj, përcaktoi rolin e ideologjisë në letërsi, përzgjodhi rreptësisht temat që duhet të trajtonte letërsia, përzgjodhi formën nacionale dhe përmbajtjen socialiste të letërsisë, mënyrën e formimit të talenteve të reja letrare, rolin që duhet të ketë kritika dhe autokritika dhe çështjen e përkthimit të letërsisë së huaj, ku u vendos që të vinte në shqip kryesisht letërsi sovjetike" ("Konferenca e III-të e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë 9-12 tetor 1949, Botim I Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, Tiranë, 1950).

Në botimin e bërë enkas për Konferencën e Tretë vetëm diskutimet e Sejfulla Maleshovës jepen të përmbledhura, ku ai del kundër "*linjës së demarkacionit*" në letërsinë shqipe".

Pas këtij momenti, letërsia që u zhvillua në Republikën e Shqipërisë u zhvendos jashtë shtratit të saj të natyrshëm historik, duke instaluar metodën e re të realizmit socialist, të importuar nga Bashkimi Sovjetik. Përgjatë viteve të mëtejshme, letërsia socrealiste formësoi *morfologjinë* e saj, si një tërësi rregullash të cilat duhet të zbatoheshin nga shkrimtarët, të cilat përfshinin të gjithë elementet që kishin të bënin me autorin, veprën dhe lexuesin.

Ky fakt që po sjellim për lexuesin dëshmon një bashkëpunim të strukturave politike dhe grupimeve të shkrimtarëve që morën pjesë në luftë, për të ndërhyrë mbi sistemin letrar, me synimin për të asgjësuar një pjese të mirë të prodhimtarisë artistike dhe ndëshkimin e disa prej shkrimtarëve kryesor modernist të asaj kohe. Vendosja e metodës së realizimit socialist në Shqipëri nuk u bë e mundur përmes një procesi të mirëfilltë debatesh teorike apo ideologjike për një letërsi të angazhuar, - siç kishte ndodhur në shumë vende të Lindjes, apo siç kishte nisur në vitet '30; apo siç vijoi në vitet 1945-45 (përmes qëndrimeve të Sejfulla Malëshovës), - por përmes mekanizmave të imponimit ekstraletrar, përmes politikës së regjimit të ri. Këtë e dëshmon fakti se në krye të grupit të shkrimtarëve antifashistë u vendos Enver Hoxha, Nako Spiro dhe Qemal Stafa. Duke e konsideruar edhe letërsinë si "letërsi klase", të ashtuquajturit shkrimtarët e luftës antifashiste asgjësuan shkrimtarët e tjerë dhe një pjesë të atyre që konsideroheshin si "shkrimtarët e kompromisit" i imponuan gradualisht që të përqafonin "letërsinë e re", pra të përqafonin metodën e realizimit socialist. Në këtë mënyrë nisi rrugëtimin e vet asgjësues letërsia e realizimit socialist, e cila shënoi një prej eksperimenteve më të rënda, me kosto të jashtëzakonshme jo vetëm mbi energjitë krijuese të shkrimtarëve por edhe në atrofizimin e vlerave të mirëfillta letrare dhe në bjerrjen e shijeve letrare të lexuesit deri në rrëzimin e sistemit komunist në Shqipëri.

(Ky material është përgatitur për konferencën kombëtare "Letërsia dhe Kujtesa", mbajtur në Razmë, Shkodër, në maj të këtij viti)

A kishte dinjitet brenda sistemit të Realizmit Socialist?

Nga Ben Andoni

Një sistem me një ideologji kulturologjike, si Sistemi i Realizimit Socialist, mund të gjyko het për korpusin e veprave të disiplinave të ndryshme që i ka dhënë publikut, mesazhet dhe impaktin në jetën e kombit. Të treja këto mund t'i ndajmë qartazi, kur vjen puna me trashëgiminë në Sistemin e Realizmit Socialist. Manualet kulturore e përcaktojnë Realizmin Socialist *si një teori estetike marksiste, që bënte thirrje për përdorimin didaktik të letërsisë, artit dhe muzikës për të zhvilluar ndërgjegjen shoqërore në një shtet socialist në zhvillim.* Sot, kjo utopi, ka mbaruar dhe Shqipëria si simotrat e saj në Lindje bëjnë një art që është larg këtij realiteti. Vetë Rusët, që e lindën, por që u mbështetën tek kolosët e tyre të artit të shekullit XIX, do ta modifikonin Realizmin Socialist në dekadat pas vdekjes së Stalinit, duke i futur shumë modernizëm, por duke përcjellë edhe një art, që në disa disiplina ishte shumë elitar. Këtu nuk është vendi për ta përshkruar këtë, por për të folur për Realizmin Socialist në Shqipëri dhe dogmën, që u ruajt aq e fortë tek artistët shqiptarë, madje edhe kur nuk u kërkohej. Paradoksalisht, edhe brenda Realizimit Socialist, Shqipëria mund të krenohet se prodhoi shkrimtarin më të madh të historisë së saj kulturologjike Ismail Kadarenë. Një sërë autorësh në letërsi, me më shumë kufizime, u munduan edhe në valën më të madhe të dogmës dhe represionit të bënin një art ndryshe. Interesant ishte qasja në artet pamore të Abdurrahim Buzës, Maks Velos, Edison Gjergos, ashtu si edhe arritjet në muzikë të Zadesë, Tish Daisë, Feim Ibrahimit...

Ndikimi i artit të Realizmit Socialist ende mund të shihet tek ne dhe me sa duket do ndjehet edhe për një kohë të gjatë, për fatin e keq në mënyrën sesi konceptohet veçanërisht letërsia e sotme, por edhe arti në përgjithësi dhe qasja ndaj tij. Të paktën nga forma. Nga ana tjetër, është e pakuptimtë, sesi Shqipëria nuk mundi të ndryshonte, kur vetë Rusia, atdheu i Realizimit Socialist, u krijoi mundësi artistëve të eksperimentonin me teknika të reja. Interesant është se artistët e mirë kudo në ish-Kampin socialist filluan të punonin me një sens ironie brenda sistemit dhe veprat e tyre janë krenari sot e kësaj dite për rrokjen e temave. Në Shqipëri duhet të jemi të ndërgjegjshëm se i gjithë komuniteti i artistëve u vendos në shërbim të këtij sistemi, duke i shërbyer regjimit dhe duke e fshehur shumë realitetin me të cilën përballej shqiptari i thjeshtë, përkundrejt dhe edukimit, ku ata kontribuuan, që ndikoi në shformimin e gjeneratave të tëra. Anipse, njerëzit që merren me studimet kulturologjike, duhet që të ndajnë mesveti natyrën e vërtetë të Realizimit Socialist, sa e ndihu artin shqiptar të kapërcente fuqinë e tij dhe impaktin e tij të mekët para luftës së Dytë Botërore, dhe çfarë mjedisi i la artit shqiptar të ditëve tona.

Kjo mbase kërkon vlerësime të thella, por edhe faktin nëse ky Sistem arti pati apo jo vlera për kulturën shqiptare! Me të drejtë, kulturat perëndimore e shikojnë me ironi të thellë Realizimin Socialist dhe si një mjet represioni, por edhe si një formë totalitarizmi që ngatërron shprehjen artistike dhe pengesë në thellësi për përparimin e kulturës. Por, a ishte në varfërinë e vet më shumë propagandë sesa art?! Pyetja ka një përgjigje të qartë që e lidh me propogandën, kurse impakti për shoqëri të pazhvilluara si shoqëria shqiptare, kërkon një studim mirëfilli.

POEZIA

Përkthyesi i njohur Çina ka bërë një përzgjedhje të vetën të disa poezive të autores së tij të preferuar nobeliste dhe e sjell për publikun e "Milosao". Autorja, një emër i madh i poezisë bashkëkohore, shërbeu si një transmetuese e dinamikës së qytetërimit të sotëm përmes vargjeve të saj...

Nga Wislawa Szymborska

E KERKON REALITETI

E kërkon realiteti
që edhe për këtë të thuhet:
jeta vijon më tej.
Kjo ndodh në Kanë dhe në Borodino
dhe në Fushë-Kosovë dhe në Guernicë.

Ka një stacion benzine
në sheshin e vogël të Jerikos,
sapo janë lyer ata stola
në Malin e Bardhë.

Letrat venë e vijnë
nga Pearl Harbour deri te Hastings,
një furgon me mobilie po udhëton
nën vështrimin e luanit nga Cheronea,
ndërsa drejt kopshteve të lulëzuara afër Verdun'it
afrohet vetëm fronti atmosferik.

Ka aq shumë Gjithçka,
sa Asgjëja nuk është mbuluar keq.
Nga jahtet poshtë Akcjumit
dëgjohet një muzikë
dhe në ato ura nën diell çiftet vallëzojnë.

Aq shumë gjëra ndodhin përherë,
të cilat duhet të ndodhin gjithandej.
Ku guri mbi gur,
atje ka një vozë me akullore
rrethuar nga fëmijët.
Ku ishte Hiroshima
atje përsëri është Hiroshima
dhe prodhohen shumë sende
përdorimi të përditshëm.

Nuk është pa gjë tërheqëse kjo botë e tmerrshme,
nuk është pa ato agime,
për të cilat ia vlen të zgjohesh.

Në fushat e Maciejoëice's
bari është i gjelbër
veç mbi atë bar, siç ndodh mbi barin,
ka një vesë të tejdukshme.

Mbase nuk ka vende të tjera si ato fushëbetejat
që ende mbaheshin mend,
tashmë të harruara,
pyje mështeknash dhe pyje qitrosh,
dëborë dhe rërë, moçale me një pasqyrim ylberi.
dhe ato humnerat e një disfate të zezë,
ku për një nevojë të ngutshme
sot struke nën shkurre.

Çfarë morali vjen nga kjo – mbase asnjë.
Ajo çka rrjedh në të vërtetë është ai gjaku që thahet shpejt
dhe përherë lumenjtë, retë.

Në ato qafmale tragjike
era i shkul kësulat nga kryet
dhe s'ke ç'bën –
kjo pamje na dëfren.

* * *

EPILOGU *i* STUHISE

{…}
anija tashmë po lundron ajo ende paksa duket
është si ai lepuri që kërcen mbi barin e dendur të detit
përfitova nga kjo rrëmujë dhe qendrova me ty o Kaliban
duke të dhënë titullin e mbretit të Napolit për dinjitetin
e qytetarit të parë të këtij ishulli, ndërsa Ti o Kaliban do të jesh
vetë populli në një person, kam shpresë
se ne do të themelojmë një shtet ideal.

Jam i sigurt se Alonso që në rastin e parë
ose fare pa shkak do të grindet me Antonion
për atë mollën e krimbur të mbretërisë së Napolit
dhe ai më i shpejti do ta therë në fyt vëllanë e vet
ndërsa më pas të tjerët do të zënë të vriten në të verbër
të tradhtojnë të nxisin rebelime të thurin intriga
ose të bëjnë historinë që Klio të mund ta shkruajë
ta djegë ta shkruajë sërish dhe ta falsifikojë librin për
pasardhësit atë histori të përplasjes së milingonave të zeza
me ato të kuqet
Gonzalo me siguri po jep shpirt atje në bodrum
Ferdinandi dhe Antonio po shqyhen si minjtë

Trinkulo gazmor
pëson çoroditje
shqisash
nuk përjashtohet
që anija po vërsulet drejt Napolit
e zbrazët pa llogaritur Trinkulon
që vjen pas këtyre kasaphanave
ndërsa kapedani bosman dhe varkëtarët e tjerë
do të jenë njerëz të rëndomtë që kundërmojnë si fundi
i fuçisë

kjo nuk është për ne o Kaliban të cilin
pronari ynë trefish i madh e quajti një egërsirë
me pamje të shpërfytyruar – mendoj se ai të ka lënduar
unë përherë e parandjeja se ti ke zemër të mirë
dhe arsye të shëndoshë për gjërat në këto kohë me peshë të artë
ndërsa njerëzit
ah kam harruar të them se në ishull
krejt zotëron politeizmi dhe si te Platoni
po ashtu edhe te ne çdo gjë ka
idealin e vet vendin në panteon
ajo pra është hyjnesha e yllit në agim por edhe
hyu i këpucës së majtë i hyjneshës së vdekjes të jaguarit, hyjni e
lules së mollës
veçanërisht e frytit të saj – nga kjo poetët tanë nuk bien kurrë
pre e sëmundjes dhe nuk fëshfërijnë me fjalët si me barin
e thatë
sot kam shkruar një psalm të vogël për të derdhur lot
këndoje atë o Kaliban bri atij shtegu pishnajash
dhe mbaje mend
nxirre në pah atë sopranon e argjendtë
që me aq xhelozi e fsheh nën gurmaz
për raste të veçanta
pa vështro në qiell
gishtrinjtë e shkathët të erës endin cirkun
si prej një leshi të trëndafiltë lëvduar qoftë ky cirk hyjnor
çdo erë që lind dhe çdo erë që hesht

për ne o Kaliban ishulli – vërshimet dhe largimet e detit
mjegullat dhe tërmetet zhegu dhe acari i natës
do të jemi si në një djep elementësh llogariten vetëm ato
që janë të rëndësishme siç janë uji zjarri humnerat e qiellit
dhe honet qiellore

- mendoj se pajtohesh me mua o Kaliban
se regjimi ynë do të jetë (i drejtë)
në ditët çift Ti do të qeverisësh në ditët teke - unë
për formën më fisnike të qeverive
të mos e vrasim mendjen tani
të merremi me fenë se ajo ndërkaq është e rëndësishme
- ne me drojë besojmë në pavdekësinë e shpirtit
s'prish punë nëse do të ishte ndryshe. Kjo nuk duhet
të jetë pengesë në prirjen drejt nderit, asketizmit të përkorë
{Këtu ndërpritet dorëshkrimi.
Numurimi i faqeve me gjasa vjen nga Z.H.}

* * *

INTERVISTE ME ATROPOS

Zonja Atropos?

E saktë, unë jam.

Nga tre vajzat e Domosdoshmërisë
Zonja ka opinionin më të keq në botë.

Një sugjerim i thekshëm, moj ti poetja ime.
Kleto po end fillin e jetës,
veç ky fill është i imët,
atë nuk është vështirë ta presësh.
Lachesis me purtekë përcakton gjatësinë e tij.
Këto nuk janë të pafajshme.

Ndërkaq në duartë e Zonjës janë dorashkat.
Derisa janë, unë ato po i përdor.
Po shoh se madje edhe tani që po bisedojmë…
Jam e varur nga puna, këtë natyrë kam unë.

A nuk ndjeheni, Zonjë, e lodhur, e mërzitur,
e përgjumur, të paktën natën? Jo.Vëtet jo?
Pa pushime, fundjavët, kremtime festash,
qoftë edhe pushime të shkurtra sa për një cigare?

Këto gjëra do të ishin një prapambetje, ndaj kjo nuk më pëlqen.

NJë zell i pakuptueshëm.
Dhe nga askund fakte për mirënjohje,
dekorata, vlerësime për njerëz të shquar, kupa, medalje?
Qoftë edhe diploma stisur në kornizë?

Si te berberi? Faleminderit përzemërsisht.
A ju ndihmon dikush, Zonjë, nëse po, kush?
Një paradoks jo i keq – pikërisht ju, vdekatarët.
Diktatorë të ndryshëm, fanatikë të shumtë.
Ndonëse nuk jam unë që i nxit.
Ata vetë u përvishen këtyre punëve.

Me siguri edhe luftërat duhet ta gëzojnë Zonjën,
se e madhe është ndihma prej saj.
Të më gëzojë? Unë nuk e njoh një ndjenjë të tillë.
Dhe nuk jam unë që u bëj thirrje,
nuk e drejtoj unë ecurinë e tyre.
Veç e pranoj: pikërisht në sajë të tyre
mund të jem në vijim.

Nuk ju vjen keq Zonjë për ato fije prerë aq shkurt?
Më shumë shkurt, më pak shkurt –
vetëm për ju është ky ndryshim.

Por nëse dikush më i fortë do të donte ta heqë qafe Zonjën
dhe të provonte ta çonte në pension?

Nuk e kuptova. Shprehu më qartë.

Po ju pyes ndryshe: a keni ju Zonjë një drejtor?
Ju lutem ndonjë pyetje tjetër.
Nuk kam më të tjera.
Atëhere lamtumirë.
Veç duke e marrë këtë si një gjë më të saktë…
E di, e di. Mirupafshim.

* * *

MENDIMET QE ME KAPLOJNE NE ATE RRUGE TERE LEVIZJE

Fytyrat:
Miliarda fytyra në këtë sipërfaqe të botës.
Me gjasë secila ndryshe
nga ato që kanë qenë dhe do të jenë.
Ndërsa Natyra – se atë kush e njeh atje –
mbase lodhur nga punët pa pushim
përsërit idetë e veta të dikurshme
dhe na vë fytyra
të cilat kanë qenë mbajtur dikur.

Mbase po të kalon pranë Arkimedi me xhinse,
Carica Katerinë me veshje nga tregu i mallrave të përdorura,
një faraon me çantë, që mban syze.
Vejusha mbas një këpucari këmbëzbathur
nga ajo Varshavë ende vocërrake,
një mjeshtër nga shpellë e Altamirit
me nipërit për në ZOO,

një Ëandal leshtor në rrugë për në muze
që paksa mahnitet.

Disa të rënë dyqind shekuj më parë.
pesë shekuj më parë
dhe gjysmë shekulli më parë.
Dikush mbartur këndej me një qerre veshur në ar,
dikush me vagonin e shfarosjes.

Montezuma, Konfuci, Nabukodonozori,
dadot e tyre, rrobalarëset e tyre dhe Semiramida
që flet vetëm anglisht.

* * *

MIRESJELLJA E TE VERBERVE

Poeti po u lexon vjersha të verbërve.
Nuk e kishte parashikuar që kjo do të ishte aq e vështirë.
Atij po i dridhet zëri.
I dridhen duart.

Ai e ndjen se këtu çdo fjali
është vënë në provë të errësirës.
Atij do t'i duhet vetë t'ia dalë mbanë,
pa drita dhe pa ngjyra.

Një aventurë e rrezikshme
për yjet në vjershat e tij,
për aurorën, ylberin, retë, neonet, hënën,
për atë peshk nën ujë që deri tani është krejt i argjendtë
dhe petritin aq të qetë, atje lart në qiell.

Ai lexon – se tashmë është tepër vonë për të mos lexuar –
për atë çunin me një xhup të verdhë në luadhin e gjelbër,
për ato çati të kuqe që mund të numërohen në atë lëndinë,
për ato numra të lëvizshme në këmishat e lojtarëve
dhe për atë të panjohurën lakuriqe në dyert e çelura.

Ai do të donte t'i bënte të heshtnin – ndonëse kjo është e pamundur –
të gjithë këta shenjtorë në atë bërryl të katedrës,
këtë gjest lamtumire nga dritarja e vagonit,
këtë lente mikroskopi dhe vezullimin e unazës
si dhe ekranet dhe pasqyrat dhe albumin me figura.

Veç e madhe është mirësjellja e të verbërve,
i madh është mirëkuptimi dhe zemërgjerësia.
Ata dëgjojnë, qeshin dhe duartrokasin.

Madje dikush prej tyre afrohet
me një libër të hapur përmbys,
duke u lutur për një autograf që vetë nuk do ta shohë.

* * *

NE KARROCEN E POSTES

Imagjinata më detyron të kryej këtë udhëtim.
Në çatinë e karrocës kutitë dhe pakot po lagen.
Brenda ka një shtrëngim, rrëmujë që të zihet fryma.
Eshtë një amvise trashaluqe, e djersitur,
një gjahtar në tymrat e pipës me një lepur të ngordhur,
një abbe* që gërhit duke përqafuar një shishe vere,
kujdestarja me një foshnjë skuqur nga klithmat,
një shitës paksa i pirë që nuk i ndalej lemza,
këtu një zonjë e acaruar nga gjithfarë shkaqesh,
pastaj një çun me fyell,
një qen i madh tërë pleshta
si dhe një papagall në kuvli.

Edhe dikush, për të cilin u ula nergut,
ij cili mezi dukej mes bagazheve të të huajve
por ja tek është – dhe ai quhet Juliusz Slovacki.

Ai nuk duket të jetë shumë i prirë për të biseduar.
Lexon një letër që e nxori nga zarfi i rrudhosur,
letër me siguri shumë herë e lexuar,
se fletët janë paksa thërrmuar në cepat.
Kur nga fletët bie një manushaqe e fishkur
ah! psherëtijmë të dy dhe e kapim në fluturim.

Mbase ky është çasti i duhur për t'i thënë
atë që prej kohësh e kisha në mendje.
Më falni Zotëri, por kjo është e ngutëshme dhe e rëndësishme.
Mbrrij këtu nga E ardhmja dhe e di si është atje.
Për vjershat e Zotërisë përherë kam ndjeshmëri edhe adhurim,
ndërsa Zotëria banimin në Ëaël do e meritonte njësoj si mbretërit.

Mjerisht, përfytyrimi nuk e ka të atillë fuqi,
që ai të mund të më dëgjojë ose të paktën të më shohë.
Madje as nuk e ndjen se Atë po e tërheq prej mënge.
Qetë - qetë ai e vendos manushaqen mes fletësh,
ndërsa fletët në zarf, pastaj në baule,
një çast vështron përmes asaj dritareje veshur me lotë,
më në fund çohet, kopsit pallton, kalon nëpër dyer
dhe çfarë – zbret në stacionin më të afërt.

Për disa çaste ende unë nuk po e humb Atë nga sytë.
Një picërrak po ecën me atë valixhen e tij të vogël,
drejt përpara, kryeulur,
Se dikush, ku ta dish
që askush këtu nuk e pret.

Tani në fushëpamje ka vetëm njerëz që nuk lëvizin.
Një familje e madhe nën ombrella,
një reshter me bilbil, ndërsa pas tij rekrutë që gulçojnë,
një qerre plot derrkucë
dhe dy kuaj të qerres për këmbim.
**abbe: prift i manastirit; *Wawel: Pallati Mbretëror në Varshavë*

* * *

NJË PAMJE ME KOKRRIZEN E RERES

Atë e quajmë kokërr rëre.
Por ai nuk e quan vehten as kokërr as rërë.
Mund të jetë edhe pa emër
të përgjithshëm, të veçantë,
kalimtar, të qëndrueshëm,
të gabuar apo të mirëfilltë.

Nuk e përfill vështrimin, prekjen tonë.
Nuk ndjehet e kqyrur dhe e prekur.
Dhe që ra në parvazin e dritares
kjo është vetëm një ndodhi e jonë, jo e atij.
Për atë është njësoj si të rrëzohet mbi çfarëdolloj gjëje,
pa asnjë siguri nëse tashmë është rrëzuar
apo ende vazhdon të rrëzohet.

Nga dritarja ka një pamje të bukur mbi liqen,
veç këtë pamje ai vetë nuk po e sheh.
Pa ngjyrë dhe pa formë,
pa zë, pa aromë
dhe pa dhimbje ai ndjehet në këtë botë.

I pafund ky fund i liqenit
dhe pa asnjë breg atyre brigjeve.
As i njomë as i thatë uji i tij.
As të vetme as me shumicë ato valë,
që shushurijnë të shurdhëta me atë shushurimën e vet
rreth atyre gurëve as të vegjël as të mëdhenj.

Ndërsa e gjithë kjo nën atë qiell prej natyre pa qiell,
në të cilin perëndon dielli pa perënduar fare
dhe fshihet pa u fshehur pas kësaj reje të pavetëdijshme.
Era e shpërndan atë pa asnjë shkak tjetër,
Veç atij që fryn.

* * *

TE ARKA

Filloi të bjerë shi pa pushim.
Te arka, se ju diku do të shkoni:
vjersha për një zë të vetëm,
hove private,
jo doemos talente,
kureshtje e tepruar,
brengosje dhe druajtje që nuk zgjatin,
moj dëshirë për t'i vështruar gjërat nga gjashtë anë.

Lumenjtë fryhen dhe dalin nga brigjet.
Te arka: dritëhije dhe gjysmëtone,
trille, zbukurime dhe hollësi,
përjashtime të marra,
shenja të harruara,
variante pa fund me ngjyrë të hirtë,
moj lojë për lojën
dhe ti lot i buzëqeshjes.

Me ç'të zë syri, ujtë dhe horizonti në mjegull.
Drejt arkës: planet janë për një të ardhme të largët,
hare nga ndryshimet,
admirim për më të mirët,
përzgjedhja jo e kufizuar tek njëri nga të dy,
skrupuj daleboje,
o kohë për ti thirrur mendjes
dhe ti o besim, se e gjithë kjo
një ditë ende do të duhet.

Për shkak të fëmijëve,
të cilët vazhdojmë të jemi,
përrallat përfundojnë për mirë.

Edhe këtu asnjë fund tjetër nuk vjen pas.
Pushon shiu,
ulen valët,
në qiellin e kthjelluar
shtrihen retë
dhe do të jenë sërish
ashtu siç u ndodhi atyre reve mbi njerëzit:
ngritur lart dhe jo aq thekshëm
në ngjashmërinë e tyre
me ishujt e lumtur
që po thahen në diell
me manaret,
lulelakrat
dhe pelenat.

* * *

URREJTJA

Shikoni, sa e aftë është përherë,
sa mirë mbahet
urrejtja në shekullin tonë.
Sa lehtë i merr pengesat e mëdha.
Sa lehtë e ka të hidhet, të rrëzohet.

Nuk është si ndjenjat e tjera.
Më e vjetra dhe më e reja prej tyre njëkohësisht.
Ajo vetë i lind shkaqet,
që e nxisin të jetojë.
Nëse e zë gjumi, asnjëherë me gjumë të përjetshëm.
Pagjumësia nuk ia merr fuqinë, por ia shton.

Feja jo feja –
veç të ulesh në gjunjë për t'u nisur.
Atdheu jo atdheu –
veç të shkëputesh për të rendur.
Edhe drejtësia nuk është keq në fillim.
Mandej ajo rend vetëm.
Urrejtja. Urrejtja.
Fytyrën asaj ia shpërfytyron ngërdheshja
e ekstazës së dashurisë.

Ah, këto ndjenjat e tjera –
mjerane dhe të ngathëta.
Që kur kjo vëllazëri
mund ti besojë turmës?
Vallë keqardhja
ka mbërritur ndonjëherë e para në pikëmbritje?
E dyshimtë sa dashamirës tërheq pas vehtes?
Veç ajo tërhiqet që e di fatin e vet.

E aftë, e zgjuar, shumë punëtore.
A duhet thënë sa këngë ka kompozuar?
Sa faqe në librat e historisë ka numëruar?
Sa divane të njerëzve ka shtruar
në aq sheshe, stadiume.

Mos të mashtrohemi:
ajo mund të krijojë bukuri.
Të shkëlqyera janë vezullimet e saj natën e errët.
Për bukuri shtëllungat nga shpërthimet në atë agim të trëndafiltë.
Vështirë t'u mohosh patosin rrënojave
dhe atë humor të shpenguar
për kolonën që ngrihet fuqishëm mbi to.

Ajo është mjeshtre e kontrastit
mes rropamës dhe qetësisë,
mes gjakut të kuq dhe dëborës së bardhë.
Dhe para së gjithash atë kurrë nuk e mërzit
motivi i xhelatit të pastër
mbi viktimën e njollosur.

E gatshme në çdo çast për detyra të reja.
Nëse duhet të presë, ajo pret.
Thonë se është e verbër. E verbër?
Ajo ka sy të mprehtë gjuetari
dhe sheh me guxim drejt së ardhmes
-vetëm ajo.

* * *

TEPERIM

Kanë zbuluar një yll të ri,
çka nuk do të thotë, se u kthjellua më shumë
dhe u shfaq diçka që ka munguar.

Ky yll është i madh dhe i largët,
aq i largët për të qenë i vogël,
madje më i vogël se ata të tjerët
shumë më të vegjël se ai.
Habia nuk do të ishte ndonjë çudi,
vetëm nëse ne do të kishim kohë për të.

Mosha e yllit, masa e yllit, vendosja e yllit,
e gjithë kjo mbase mjafton
për një tezë doktorature
dhe një gotë të vogël vere
në rrethet afruar qiellit:
astronomi, e shoqja, të afërmit dhe shokët,
atmosferë e çlirët, veshja sipas dëshirës,
në biseda mbizotërojnë tema vendore
dhe përtypen kikirika.

Një yll i shkëlqyer
veç ky ende nuk është shkak
të mos ngrihet një dolli për shëndetin e zonjave tona
pakrahasueshëm më të afërta.

Një yll pa rrjedhoja.
Pa ndikim në motin, modën, përfundimin e ndeshjes,
ndryshimet në qeveri, në të ardhurat dhe në krizën e vlerave.

Pa rrjedhoja në propagandë dhe në industrinë e rëndë.
Pa u pasqyruar në llustrën e tryezës së bisedimeve.
Me një shifër të tejkaluar për ditët e llogaritura të jetës.

Përktheu nga origjinali Pandeli Çina

POEZIA

Rezidenca e autorëve "POETEKA – Tirana in Between" mirëpriti gjatë muajit korrik 2017 një autore të vlerësuar dhe një mike të veçantë: Jasna Shamiç, shkrimtare, studiuese, autore e 16 librave në frëngjisht, e 11 librave në gjuhën boshnjake, realizuese e 10 filmave dhe dokumentarëve si dhe e mjaft dramave e cila, prej vitit 1977, jeton midis Sarajevës dhe Parisit, mes kulturës perëndimore dhe asaj orientale, mbi të cilat edhe ka kryer studime të thelluara dhe mes letërsisë e filmit si krijimtari

PËR JASNA SHAMIÇ

Programi i qëndrimit të Jasna Shamic në Rezidencën e shkrimtarëve dhe përkthyesve letrarë (i cili mbështet autorë nga rajoni dhe Europa dhe zhvillohet prej 5 vjetësh në Tiranë dhe qytete të tjerë të Shqipërisë, vjen si bashkëpunim me rrjetin TRADUKI, me Ministrinë e Kultures dhe disa prej Ambasadave të shteteve të ndryshme me qendër në Tiranë) i ofroi edhe kësaj autoreve mundësi të gjera për t'u përfshirë në jetën kulturore të kryeqytetit shqiptar dhe të disa qyteteve të tjerë, që kanë tërhequr vëmendjen e kësaj autoreje lidhur me traditat kulturore, të tillë si Durrësi, Berati, Kruja, si dhe përfshirjen në veprimtari të tilla si "Hemingway's Day (ku Jasna Shamiç ndau me publikun e gjerë pvrvojat e saj gjatë vizitave në Kubë dhe tekstet që ajo ka shkruar mbi Hemingway-n) apo Festivalin e Jazz-it.

Veprimtaritë e Jasna Shamiç lidhen me specifika e shkrimeve, studimeve dhe filmave të realizuar nga ajo, që nga shkrimi i një romani epistolar e deti tek një teks mbi suveniret dhe shkrimtarët. Interesa të autores janë gjithashtu trashëgimia artistike dhe joartistike e totalitarizmit apo gjurmët. Përpos këtyre në interes të saj ishin historia e besimeve dhe e kulteve, tema e mistikës dhe e sufizmit (për këtë ajo ka vizituar dhe krijuar kontakte me Muzeun Kombëtar si dhe me Muzeun Bektashian, Tiranë, *Sari Salltik* që ndodhet në malin mbi Krujë.

Gjatë qëndrimit të saj në Tiranë Jasna



Shamiç ka botuar në portale të rëndësishme dy artikuj e reportazhe ne tematikën e Shqipërisë (BEKTAŠIJSKA TEKIJA TIRANA; TIRANA I TIRANI) , të cilat do të jenë pjesë e librit më të ri të saj, që është në proces botimi.

Jasna Shamiç ka lindur në Sarajevë (1949), qytet ku dhe ajo ka filluar shkollimin e më pas ka kryer studimet e larta në sistemin liceum, konservator, shkollë muzike dhe në vijim në Universitetin e Sarajevës, ku studioi gjuhë dhe literaturë orientale: gjuhë dhe letërsi perse, arabe dhe turke.

Më pas ajo ka kryer specializime dhe teza pasuniversitare për Gjuhësi të Përgjithshme dhe Turkologji, duke u thelluar me mbrojtjen e tezës doktorale pranë Fakultetit Filozofik të Sarajevës (1977), në Universitetin e Parisit - Sorbonne Nouvelle, ku ajo paraqiti Doctorate d'Etatès Lettres (1984) me temën e saj mbi Sufizmin dhe Historinë.

Jasna Shamiç ka qenë Profesor i Letërsisë Orientale në Universitetin e Sarajevës (përjashtuar pa arsye bindëse nga Fakulteti në vitin 1992). Në vitin 1992 ajo ushtroi detyrën si Drejtor i Kërkimeve Shkencore lidhur me CNRS (Qendra Kombëtare Franceze e Kërkimit) dhe më pas si Profesor i Gjuhëve, Letërsisë, Historisë dhe Qytetërimit të Ballkanit pranë Universitetit "Marc Bloch" të Strasburgut, ku dhe bashkëpunoi me programet e Radios franceze: "Radio France Internationale" dhe "France Culture".

Që nga viti 1974 Jasna Shamiç ka qenë anëtare e Bashkimit të Shkrimtarëve të Bosnjës. Duke filluar nga viti 1996 ajo është gjithashtu anëtar i Bashkimit të Shkrimtarëve të Francës. Në vitin 2006 ajo u pranua anëtare e Klubit Ndërkombëtar PEN për Bosnjën dhe Hercegovinën.

Në të shkuarën dhe sot Jasna Shamiç ka bashkëpunuar me revista letrare të njohura në rajonin tonë dhe në Europë, ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare në shumë qendra studimore të botës dhe ka dhënë leksione në mjaft universitete të ish-Jugosllavisë dhe Europës. Jasna Shamiç është Drejtor i Knji•evna sehara (www.balkan-sehara.com) për shqyrtimet letrar.

Si autore e shumë librave (poezi, romane,) ajo ka botuar në gjuhën frënge dhe në gjuhën boshnjake. Shkruan gjithashtu edhe filozofi dhe ese.

Në vitin 2008 Jasna Shamiç fitoi Çmimit Letrar "Stendhal" (Lauréate du program Missions Stendhal). Në vitin 2014 fitoi Çmimi "Gauchez-Pillippot". Gjatë viteve 2014 dhe 2015 ajo është vlerësuar me Çmimin e Botuesve Boshnjakë.

Jasna Shamiç

QYTETI I LINDJES

Duket sikur çdo gjë kalbet
Dhe mendja jote rëndon
Thithur nga kujtesa
E qytetit të transformuar
Në një pus ku
Dukatët e hajdutëve dhe
Lakenjtë e së keqes shkëlqejnë
Ku martirët krekosen
Për burgun e tyre të dhimbjes

Shpirtra të përgjakshëm
Kqyrin në heshtje
Lakenjtë e së Keqes
Dhe dukatet e tyre

Duket se çdo gjë kalbet
Përveç:
Lakenjve e së Keqes
Dhe dukateve të tyre

(*Sarajevë*)

URA

Para se të ishte e bardhë, ishte gri
Para se të ishte e fortë, ishte si një valë
Përa se të ishte një ylber, ishte një shteg i dallgëzuar mes dy fortesash
Dhe shtatëmbëdhjetë shtëpi ku jetuan
Një beqar dhe Mostari

Sulltani i ofroi qytetit një urë -
Një ylber -
francezi tha: Është më madhështore se Harku i Triumfit
italini: Është më e fortë se Rialto
turku: Është më e lartë se një minare
Dhe arabi tha: Kjo është një deve e bardhë

Poeti shkroi: Kjo është një mjellmë me qafë të përkulur
Një pulëbardhë me krahë të hapur
Mali me borë
Mbi lumë

Për shekuj me radhë pulbardhat ulen
Në shpinën e devesë, ngjyra e borës,
Për shekuj pulëbardhat ngrihen
Nga shpina e devesë drejt Narentas
Përkunden nën devenë e bardhë
qetë dhe etshëm
Ngjyrë nefriti

Kur barbarët e sulmuan
Ylberi u bë pasqyrë e thyer
Shpina e devesë - anije e mbytur
Harku – pishtar akulli
Krahët e pulëbardhave - dy duar të prera
Midis dy anëve:
Një plagë

RAPSODIA E NJU JORKUT

Gjatë asaj vjeshte
Nju Jorku u spërkat
Nga zjarri
Dhe ketrat në Central Park
U pagëzuan nga ndryshku
Ndërsa po shkoje në pelegrinazhin
E Bukurisë

Ti po zbuloje të shkuarën tënde -
Natyrën tënde, të cilën tashmë e njihje-dhe që e kishe shtypur me këmbë.

Gëzimi derdhet nga pemët
Zhytur në flakë
Dhe shpërndahet si një ylber mbi qiell
Mbi degët dhe mbi
Shtigjet e Parkut
Njëlloj si një urë përmes oqeanit
Dhe kohës

Si *Gruaja me të Zeza* e
John Singer Sargent
Ti ishe shekullore
Ndezje zjarre teksa ecje
Mbytur mes gjethesh të thara si
si mbi qilimin e butë të lutjes

Kalimi përmes shtegut
Kur shkuat në pelegrinazh
Për t'ju përulur
Bukurisë

Dhe për të takuar
Rioshin Bronzino
Para se t'i bashkohej ishullit Böcklin
Ndërkohë që Mezzetin këndonte
Serenatën e tij për ju mbi një stol
Duke vështruar qiellin blu
Dhe Louise de Broglie ishte
Veshur me të njëjtën blu
Duke të t'vështruar ngado që shkoje

Nëse ke qenë vetëm
Apo me mikun tënd
- Që gjithashtu dukej
i larë me zjarr -
Nëse je në West Village
Apo në East Village
Duke darkuar së bashku
Nën flakën dridhëruese
Të qiririt
Magjia ju mëkon me gji
Qumështi i saj
Pikuar nga perëndimi shumëngjyrësh

Edhe sot ndonjëherë
Kur je e vetmuar
Ti thith kujtimin e
Rapsodisë së Nju Jorkut
Të cilën ai ta kushtoi ty,
Me sytë e tij të trishtë

Ti përhap muzikën e tij
Në vende të fshehta të
Ditës
Duke menduar fytyrën e tij
Të hollë si një shpatë dhe
Përkëdhel me sytë tu
Sytë e tij
Mbushur me dëshirë
Nën flakën dridhëruese
Të qiririt

Kur prerja e mjegullës
Me këmbët tuaja
Pamjen e Parisit
Rishfaqen para teje

PARISI

Paris ndonjëherë të kujton
një lak të padukshëm
fshehur pas perdeve
të ndjesive të trazuara
e buzëqeshjeve të brishta

Vërtetë shpirti im
është dënuar nga kjo?

Ndonjëherë është burg
me porta të hapura
drejt vetmisë
drejt erërave të gjuhëve
që ulërijnë si çakejtë.
Dhe shirat që shfryjnë si erërat
teksa një fjalë e ashpër
krijon oden e trishtimit.

Shkojnë (kalojnë) fantazmat e të vdekurve
të mi
përgjatë deteve imagjinare
para syve gjysmë-mbyllur
si veliera
të zymta e të qelbura
rënduar nga shpresa të rreme
duke më kujtuar qytetet antike
dhe jetët e mia të shkuara.

A ka gjë më të trishtë se të sjellësh ndërmend
gëzimet?

Me imazhet e gëzimit përzihet
ajo e djaloshit me qafë të prerë
e një gruaje me trupin e coptuar
e një njeriu që si një buall ripërtyp
jashtëqitjen e tij
Ky planet
kjo anije mostrash
këndon psalme funebre
dhe këlthet si një zog grabitqar.

Qytete e mia janë në zi
Parisi herë është burg
e herë harè
që thyen zinxhirët e trupit
dhe harbon

Herë bëhet ëndërr
mes goditjes së kambanave
si një tufë e macesh të lagura në lumin
mbushur me fekale.

QYTETI DHIMBJE

Në të dy anët e qytetit dhimbje
ngrihen
dy shkurre gjigande
e mes gardheve të gjelbër
të zgavrave pa sy janë shtëpitë

Një plak një burrë një qen dhe një nuse
plot nur
e thërrmojnë dhimbjen
për të bërë përpara

Papritur dëgjohet
një e qeshur

E qeshura e ndonjë të huaji
larë më lotët
e të masakruarve
(në kujtim të Srebrenicës, 2016)

Përktheu Silvana Leka

SHKRIM SH

Autorja, ish studente në Rusi, na vjen me shënime udhëtimi nga vendi me të cilin është i dashuruar. Nuk kam për qëllim të tregoj të gjitha çfarë pashë gjatë kësaj vizite të shkurtër, sepse është e pamundur të mbahen mend, por do desha t'ju tregoja sa kishte ndryshuar vendi ku unë kalova vitet e rinisë, ku u rrita si moshë dhe si njeri, ku mora kulturë dhe drejtim në jetë, shprehet ajo...

SY MË SY ME MOSKËN madhështore… …me SHËN-PETËRBURGUN magjik, … me njerëzit, … me lumin… .

(Mbresa nga vizita në Moskë dhe Shën-Petërburg)

Nga Myzejen Shapllo

Në fund të këtij qershori m'u dha rasti të bëj një vizitë të shkurtër në Moskë dhe në Shën- Petërburg.

Për mua ishte një gëzim i madh t'i vizitoja për të tretën herë mbas njëzet e dy vjetësh nga udhëtimi im i fundit, shtëpitë-muze, rrugët dhe vendet ku kanë jetuar e janë frymëzuar shkrimtarët e mëdhenj të Rusisë, parqet, urat, stacionet e reja të metrosë, këto qytete me arkitekturë nga më madhështoret, Sheshin e Kuq, këtë simbol të Moskës, katedralet, muzeun e Carëve të Rusisë. Veçanërisht ishte mahnitës për mua muzeu që i kushtohej betejës së famshme në Borodino të Moskës në vitin 1812, midis ushtrisë së Napoleon Bonopartit dhe ushtrisë ruse të udhëhequr nga strategu rus Kutuzov, të realizuar nga piktori Franz Aleksejeviç Roubaud.

F. Roubaud ishte lindur në Odesë në vitin 1856 nga prindër francezë, familje e një tregtari të fuqishëm. Në Odesë mësoi në shkollën për vizatim, pastaj vazhdoi në Akademinë e Arteve në Mynhen, ku u specializua për pikturën e betejave të mëdha. Ai e kish pasqyruar betejën me një panoramë të gjerë, e cila falë kombinimit të tablosë tredimensionale e jepte iluzionin e ngjarjes historike në sytë e spektatorit sikur ndodhte në atë çast.

Kur pashë Universitetin Lomonosov të ngritur në "Varabjovë Gorë" (dikur quheshin Kodrat e Leninit), me mendje u ktheva në vitet kur kam studiuar atje dhe nuk më besohej që unë po qëndroja tani në mes të sheshit me fytyrë nga Universiteti, me kokën ngritur lart duke e parë këtë ndërtesë të lartë me 36- kate, dhe më dukej sikur po kthehesha nga Leksionet, të cilat i zhvillonim në Manjezh.

Nuk kam për qëllim të tregoj të gjitha çfarë pashë gjatë kësaj vizite të shkurtër, sepse është e pamundur të mbahen mend, por do desha t'ju tregoja sa kishte ndryshuar vendi ku unë kalova vitet e rinisë, ku u rrita si moshë dhe si njeri, ku mora kulturë dhe drejtim në jetë.

Duke qenë sy më sy me Moskën dhe e emocionuar herë midis ëndrrës dhe reales, humbisja orientimin, nuk po i njihja vendet ku kisha kaluar shpesh, nuk po e gjeja Manjezhin ku i zhvillonim leksionet. Rruga Gorkij tashmë quhej Tverskaja, por Arbatin e vjetër nuk e kisha harruar.

Ndryshimet ishin të pa para. Natyrisht kishin kaluar njëzet e dy vjet nga udhëtimi im i fundit dhe në këto vite Moska ishte zmadhuar, kudo shihje ndërtesa të larta, parqe, rrugë të reja. Dhe mua, që ndihesha ende në këto çaste si e përhumbur, midis ëndrrës dhe reales, mendja më shkoi tek Tirana nga e cila sapo isha larguar. Tirana jonë ndryshoi brenda katër viteve aq shumë sa dhe ne që jetojmë atje tërë jetën, nuk i njohim rrugët dhe lagjet e dikurshme aq shpejt të transformuara dhe gëzohemi kur mendojmë se mbas një kohe jo të gjatë Tirana do të marrë pamjen e një kryeqyteti europian.

Moska e sotme

Moska që shikoja tani nuk ishte si në ato vite. Para syve të mi ngriheshin rrokaqiej, sytë të shikonin hapësira pa fund, rrugë të gjëra me katër korsi, të shtruara mirë, të pastra, gjelbërimi i pafund të mbetej në sy dhe të jepte një shikim të gjelbër shpresëdhënës për botën që na rrethon duke ëndërruar që njerëzimi të ketë paqë. Kudo shikoje njerëz të shumtë që ecnin me hap të shpejtuar, nxito dhe ti që mos mbetesh pas, ec dhe ti me ritmin e kohës! Unë vura re se dhe në Moskë librin që rusët nuk e ndanin nga dora kudo që ndodheshin, në metro, autobus, tramvaj, në ndonjë radhë apo në park, e kishin zëvendësuar si kudo në Europë me mjetin modern elektronik, celularin...

Moska që shikoja tani nuk ishte si në ato vite. Para syve të mi ngriheshin rrokaqiej, sytë të shikonin hapësira pa fund, rrugë të gjëra me katër korsi, të shtruara mirë, të pastra, gjelbërimi i pafund të mbetej në sy dhe të jepte një shikim të gjelbër shpresëdhënës për botën që na rrethon duke ëndërruar që njerëzimi të ketë paqe. Kudo shikoje njerëz të shumtë që ecnin me hap të shpejtuar, nxito dhe ti me ritmin e kohës! Unë vura re se dhe në Moskë librin që rusët nuk e ndanin nga dora kudo që ndodheshin, në metro, autobus, tramvaj, në ndonjë radhë apo në park, e kishin zëvendësuar si kudo në Europë me mjetin modern elektronik, celularin... Do të kisha dëshirë… po të qe e mundur, që librin ta mbanin pranë celularit… por është shekulli i elektronikës!

Gjatë rrugës për në Shën-Petërburg me trenin luksoz, para syve të mi, shikoja të kalonin me shpejtësi mështeknat, druri karakteristik i pyjeve ruse, me lëkurën e bardhë, të drejta që të kujtojnë bukurinë e vajzës ruse, këngët dhe vargjet e thurura për "berjozkën". "Por dhe vajzat tona janë shtatselvi", - mendova me vete". Kështu i këndon populli dhe i thur vargje poeti shqiptar.

Sa herë që njeriu niset për rrugë të largët, atje ku shkon lë diçka në hapësirë nga vetja, por dhe merr diçka prej saj, merr atë që do më shumë.

Në "Piter", siç i thonë shkurt vetë rusët kryeqytetit të vjetër, arrita shpejt, paradite, dhe natyrisht mezi prisja të vinte nata që të shikoja "Netët e bardha", të cilat do të vazhdonin deri nga mesnata. Ky qytet është i veçantë. Këtu të binin në sy kishat, kupolat që ndrisnin me ngjyrën e verdhë, sikur dielli kish lëshuar rrezet mbi to. Dukej sikur i gjithë qyteti ishte spërkatur me ujë floriri, sikur një vello e hollë mbulonte shtëpitë, kishat, shatërvanet nëpër parqet. Por dhe njerëzit atje janë shpirt flori, zemër bardhë dhe me një kulturë të trashëguar, me qytetërim evropian ashtu si edhe moskovitët. Te dukej sikur diku andej nga Ermitazhi do të dalë Pjetri I, themeluesi i qytetit, i cili siç thuhet "hapi një dritare në Evropë". Ne, edhe pse ra shi dhe u ftoh koha, arritëm te vizitojmë Muze-

Në Shën Petërburg

Në "Piter", siç i thonë shkurt vetë rusët kryeqytetit të vjetër, arrita shpejt, paradite, dhe natyrisht mezi prisja të vinte nata që të shikoja "Netët e bardha", të cilat do të vazhdonin deri nga mesnata. Ky qytet është i veçantë. Këtu të binin në sy kishat, kupolat që ndrisnin me ngjyrën e verdhë, sikur dielli kish lëshuar rrezet mbi to. Dukej sikur i gjithë qyteti ishte spërkatur me ujë floriri, sikur një vello e hollë mbulonte shtëpitë, kishat, shatërvanet nëpër parqet. Por dhe njerëzit atje janë shpirt flori, zemër bardhë dhe me një kulturë të trashëguar, me qytetërim evropian ashtu si edhe moskovitët. Te dukej sikur diku andej nga Ermitazhi do të dalë Pjetri I, themeluesi i qytetit, i cili siç thuhet "hapi një dritare në Europë".

e muzeut të carëve ka kaluar dhe është një nga vendet e pakta ku mund të gjesh mënjanim duke komunikuar me kulturën botërore dhe me historinë e Rusisë, ku gërshetohet historia botërore me frymën e historisë ruse. Nëpër sallat e tij të duket sikur bashkë me hijet e piktorëve të mëdhenj enden hijet e carëve, ushtarakëve dhe diplomatëve, shkrimtarëve dhe revolucionarëve. Ermitazhi jetoi një jetë të gjatë dhe të vështirë, ai pa luftëra, revolucione, zjarre, vjedhje, shitje, por edhe provoi dhe krenarinë, gëzimin dhe dashurinë vetmohonjëse.

Tani që jam sy më sy me Moskën, Shën-Petërburgun, me njerëzit, mund të them, se ky popull, pavarësisht erërave që fryjnë në botë, i ka ngritur vetes një monument të pathyeshëm, siç thotë dhe Pushkini në vjershën e tij «Monumenti».

Lexuesi shqiptar është njohur me kryeveprat e klasikëve rusë përmes përkthyesve të talentuar si Lasgush Poradeci, Sejfulla Maleshova, Mitrush Kuteli, Sotir Caci, Vedat Kokona, Tajar zavalani, Petro Zhej, Dritero Agolli, Dhori Qirjazi si dhe një radhë përkthyesish të mëvonshëm. Lexuesi shqiptar ka një admirim për shkrimtarët ruse dhe gjithmonë ka treguar e vazhdon të tregojë interes për letërsinë e ruse. Shkrimtarët ruse si, Dostojevski, Çehovi, Turgenjevi, Tolstoji e të tjerë, e të tjerë, janë një krenari për Rusinë, janë emra që i përkasin dhe botës. Tek ne idetë e tyre kanë qenë dhe janë burime për meditim, njohje e frymëzim, mesazhe të rëndësishme humane për të kërkuar të

→ Vijon në faqen 20

MEA CULPA

MILOSAO

Léon Heuzey dhe Honoré Daumet

Dy artistët e Napoleon III në gjurmë të Çezarit në Shqipëri

…nga numri i shkuar

"Milosao" kishte një shkrim shumë të gjatë historik të Luan Ramës, kushtuar udhëtimit të dy artistëve të njohur frëngë në kohën e Napoleonit III, me urdhrin e tij për të hulumtuar vendet ku kishte luftuar Çezari, por edhe shumë gjëra që lidheshin me antikitetin e Shqipërisë dhe të gjithë Ballkanit. Ata ishin arkeologu Léon Heuzey, anëtar i "Akademisë së Arteve të Bukura" si dhe i "Akademisë së Mbishkrimeve dhe Letërsisë" në Paris, dhe Honoré Daumet, arkitekt e piktor. Ata ishin nisur nga Marseille, në jug të Francës, me një anije të posaçme dhe duke rrahur detet e Mesdheut, përshkuan Detin Jon, duke shkuar thellë në Egje, për të mbërritur në Selanik. Që andej, ata morën rrugën për në Maqedoninë antike, drejt Farsales, ku ishte zhvilluar beteja e famshme dhe vendimtare midis Cezar-it dhe Pompe-ut, çka do të përfundonte me disfatën e këtij të fundit. Në natyrën e zakonshme të Luanit, publicistit dhe studiuesit të njohur, tema është trajtuar me shumë ngjyra, por disi e stërgjatë. Gjithsesi, e vlerësojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e përhershëm të tijin. Vetë redaktori shtoi një shkrim lidhur me botimin e fundit "Gorrillat që si pamë" të Veton Surroit. Për atë që e njeh veprimtarinë e Surroit, ishin përmbledhur disa esse, që kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe disa syresh kanë qenë të njohura prej kohësh për publikun kosovar. Në to mund të kuptosh shumë zhvillime për Kosovën, për të mos thënë vetë thelbin e saj dhe të gjithë kundërshtitë që e pengojnë aq shumë vendin në rrugën e vështirë të integrimit... Redaktori vërtetë e shijoi librin e publicistit të njohur kosovar për thellësinë e mendimit dhe të gjitha elementët e tjera, por edhe mënyrën e hapur sesi flet për Kosovën.
Feride Papleka në nderim të Dhimitër Shuteriqit, që ditët e fundit të korrikut pati datat e segmentit të tij jetësor, na kish sjellë disa poezi të tij, bashkë me një shpjegim bash të gjatë. *Vargjet e Bodlerit e tronditën dhe e shtangën. Nuk ishte thjesht magjia ligjëruese dhe përsosuria metrike e poezive, por brenga e thellë dhe përpjekja e poetit për të zbuluar e për të dhënë me art atë që është e veçantë në jetë.* Vërtetë e tronditën, por përqafimi i thellë i Realizimit Socialist nuk do të thoshte se ato ishin brenda tij.
Dhe, në fund, kishim një shkrim përkthim të Meri Lalaj nga autori i saj i preferuar Georges Seldes, ku përshkruhet jeta e D'Anunzios, me shumë finesë por edhe me stilin e zakonshëm qesëndisës të autorit. Meri insistoi gjatë dhe redaktori ia vonoi shkrimin, por për arsye që t'i gjente vendin e duhur, gjë e cila u mirëkuptua jo tamam nga përkthyesja, që e mori pak personale. Duhet thënë se numri ishte i mirë dhe i qartë por edhe i këndshëm... Layout punoi krejt pa qejf këtë herë, por edhe pa shumë ide...

← Vijon nga faqja 19

vërtetën, në mënyrë që njeriu të ndjehet më i sigurt dhe më i lumtur. Por shpesh lexuesi ynë kërkon të dijë më shumë për letërsinë e sotme, a ecën kjo letërsi në traditën e klasikëve, çfarë veprash janë shkruar, cilët janë shkrimtarët bashkëkohës. Ç'është e vërteta, kjo letërsi njihet pak te ne. Janë përkthyer te ne romani "Kazus Kukotski", ndonjë tregim apo novelë të shkrimtares Ludmilla Ulickaja, tregime të Viktorija Tokarjevës, disa romane policorë të shkrimtares Aleksandra Marinjina, por mbeten ende të panjohur disa shkrimtarë, veprat e të cilëve e vlejnë të përkthehen tek ne, si, Valentin Rasputin, Ludmilla Ulickaja nga e cila mund të përkthehen edhetregime e novela të tjera, Maksim Osipov, Viktor Pelevin, Tatjana Tolstaja, Anton Utkin, e disa të tjerë.

Gjatë kësaj vizite dyditore në Moskë, unë pata rastin e mirë ta takoja e të njihesha me shkrimtarin Maksim Osipov, disa tregime dhe novela të të cilit i kisha lexuar pak kohë më parë.

Dhe ja, ne u takuam në hollin e hotelit «Ibis dynamo» të Moskës, ku kisha qëndruar për dy ditë.

KUSH ËSHTË MAKSIM OSIPOV?

Maksim Osipovi është mjek kardiolog, dhe jeton në Moskë dhe në Tarus, provincë që ndodhet rreth 130 km larg Moskës. Osipovi ka punuar në Universitetin e Kalifornisë në San-Francisko, gjithashtu edhe në klinikat e Moskës. Në vitin 2005 nisi punën si mjek dhe në këtë kohë themeloi «Shoqatën bamirëse në ndihmë të spitalit të Tarusit», veprimtaria e së cilës u bë gjërësisht e njohur në vitin 2008 mbasi mjekët i bënë ballë me sukses arbitraritetit të pushtetit vendor. Në sajë të përpjekjeve të « Shoqatës bamirëse », spitali i Tarusit mori disa mjekë të kualifikuar dhe paisje moderne. Që prej vitit 2007, Maksim Osipovi boton skicat, tregimet dhe novelat kryesisht në revistën « Znamja » (Flamuri). Ka botuar katër përmbledhje me tregime dhe novela : "Është mëkatë të ankohesh" (Në 2009),"Klithma e shpendit të shtëpisë"(2011), "Njeriu i epokës së Rilindjes" (2012), "Me dallgët e detit" (2014). Ka shkruar gjithashtu tri drama, njëra prej të cilave "Rusishtja dhe letërsia" është vënë në skenë në Shën-Petërburg dhe në Omsk.

Tregimet dhe novelat e Maksim Osipovit janë përkthyer në dymbëdhjetë gjuhë; është lauruar me çmimin Jurij Kozakov për tregimin më të mirë, me çmimin e Buninit, është finalist i çmimit "Jasnaja Poljana" dhe NOS, si dhe çmimet e Bjellkinit.

Shkrimtarin Maksim Osipov e shqetësojnë probleme të jetës sociale. Ngjarjet që përshkruan i përkasin periudhës mbas shpërbërjes së ish B. Sovjetik e më vonë, emigrimit në masë, ai përshkruan varfërinë e tejskajshme, vrasjet, vjedhjet, alkolizmin, jep tablo të errëta të jetës në provincë, humbjen e dëshirës për të jetuar, njerëz pa miq, pa dëshirë për punën, të sëmurët që kanë frikë nga vdekja, por edhe të jetojnë, lidhjet e korrupsionit. Të gjitha këto M. Osipovi i përshkruan thjesht, pa zbukurime, pa pretenduar të bëjë përshkrime tërheqëse, duket sikur i bën shpejt, pa romantizëm, ai e jep realitetin ashtu siç është, siç e sheh, në frazën e tij lexuesi ndjen dhimbjen që i është mbledhur në shpirt prej vitesh nga realiteti i zymtë dhe i shëmtuar.

E veçanta e tregimeve dhe novelave të M. Osipovit, është stili i tij. Personazhet e tij kalojnë shpejt, nuk mbahen mend, nuk zhvillohen, ngjarjet nuk mund t'i ritregosh, siç ndodh te shkrimtarët e ndryshëm. Me sa duket, kjo është mënyra e tij, për t'u shprehur shkurt, me fraza që duhen nënkuptuar. Tregimet dhe novelat e tij të duken sikur nuk kanë lidhje, ngjarjet janë të ndryshme, por ato i përshkon si një fije e padukshme përpjekja për të shpëtuar nga e keqja dhe nga keqanët që kanë kapur vendin. Prandaj ky shkrimtar është i veçantë dhe kjo mënyrë e të shkruarit e bën interesante krijimtarinë e tij. Takimi me shkrimtarin bashkëkohës, shkëmbimi i mendimeve për letërsinë e vendeve tona, për përkthimet, na hapën rrugë të reja bashkëpunimi për ne.

Kur po ngrihej avioni, nga dritarja i hodha shikimin e fundit Shën-Petërburgut për ta ngulitur në sytë e mi pamjen plot dritë të qytetit dhe për të mos e ndjerë trishtimin që ka çdo ndarje. Sa më lart ngriheshim, dritat vinin e zvogëloheshin dhe dukeshin si xixëllonja që lodronin mbi qytet. Por në lartësinë më të madhe të fluturimit, kur avioni ishte ngritur mbi retë e bardha, një diell i fuqishëm më ndriçoi sytë! Unë kisha marr dhe ruajtur në sytë dhe zemrën time shkëlqimin, bukurinë dhe madhështinë e qytetit, për ta sjellë në vendin tim dhe për të mos e harruar !



Opinioni i Ditës

25 vite Rotary në Shqipëri

Nga PËRPARIM KABO

(Vijon nga faqja e parë)

... tjetër për të realizuar takimet, u quajt Rotary, ai dhe ata, as që e dinin se Shqipëria ishte një vend në gadishullin e Ballkanit me një popullsi me histori të lashtë që nga koha e mugëtirave pellazgjike. Se ai vend në Mesjetë kishte një hero Atlet të Krishterimit si Gjergj Kastriot Skënderbeu. Ata nuk mund ta dinin, se atje në ato treva flitej një gjuhë nga më të vjetrat, se në malësitë e thella vepronte e drejta zakonore dhe kishte kode që afronin shumë me të Drejtën Romake. Dhe nuk kishin si ta dinin. Shqipëria asokohe ende nuk ishte shtet i pavarur. Për pothuaj 2000 vite, gati rreth në 80 breza antropologjikë, ajo kishte qenë nën tre perandori, Perandorinë Romake, Bizantine dhe atë Turko-Osmane. Ishte krijuar te ata njerëz një lloj mentaliteti "imperial" sjellje që ravijëzonte tipin njerëzor si perandorak në qendrat imperiale ku shërbehej dhe si provinciale në atdheun nativ. Si edhe shprehet studiuesi anglez, diplomati Julius Norwich në librin e tij me titull "BIZANTI - ngritja dhe rënia e një perandorie", magjia e bizantinizmit lidhur me vendndodhjen mes Perëndimit dhe Orientit ishte... "Një trup romak, një mendje greke, një shpirt mistik oriental". Kështu u gatuam edhe ne shqiptarët në tipologjinë tonë antropologjike, por më shumë mbeti i konservuar si nënshtresë bazike paganizmi herë i butë e herë i ashpër e shpagues. Besimet e tjera monoteiste që erdhën përmes konvertimit, duke qenë se kishim të bënim me të njëjtën popullsi ndaj dhe krijuan një kohezion ku shumësia e besimeve nuk shkaktonte konflikte dhe intolerancë. Ishim dhe jemi një popull me bashkëjetesë dhe respekt të ndërsjellë fetar. Kjo është një dhuratë e kohërave, por kurrsesi e arritur lehtë. Është paguar me jetë njerëzish dhe me sakrifica jo të pakta. Forcat tërheqëse dhe ato shtytëse në krahina dhe zona të ndryshme të vendit janë ndeshur, duke përvijuar nga urrejtja deri te tragjizmi. E së fundmi triumfoi kohezioni kombëtar. Një arritje që duhet mbrujtur edhe sot, ku në kushtet e një shoqërie globale të hapur dhe që karakterizohet nga lëvizja e njerëzve, mosmbajtja e identitetit është e modës; ndërsa symbyllja e shteteve apo qeverive të tyre ndaj të larguarve është një mënyrë sjelljeje e kudondodhur, që rrezikon ikjen pa kthim të popullsive migratore. Kalvari i popullit tonë ishte i gjatë, i vështirë dhe me shumë sfida. Fatkeqësisht, demokracinë institucionale e takuam vonë, madje shumë vonë, pikërisht në hyrje të viteve '90, me rënien e perdes së hekurt dhe shembjen e murit të Berlinit. Si edhe është shprehur një nga protagonistët e tranzicionit demokratik në një rast; "Portat u hapën, por ne rrugën nuk e dinim". Shoqëria jonë do të duhej të ndërtonte 'Rule of Law', shtetin që me ligj do garantonte liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe do të ndërtonte një realitet me klimë demokratike tolerance dhe bashkëjetese në larmishmëri kulturore e politike, ku do të konkurrohej me programe dhe me alternativa. Duhej ndërtuar shoqëria e lirisë, si më e madhja sfidë, po qe se mbahen në vëmendje disa veçori, si: Kushtet historike; Mungesa e gjatë e traditës demokratike; Prapambetja ekonomike e trashëguar; Lufta e klasave aq shkatërruese gjatë shoqërisë komuniste; Izolimi i thellë nga bota; Mbyllja e institucioneve të kultit fetar dhe ndalimi i ushtrimit të së drejtës së besimit; që kishin ndodhur nën regjimin komunist.

* * *

Duke mbajtur parasysh këto kushte dhe rrethana, bëhet e qartë pse kuptimi apo vlerësimi për atë që quhet shoqëria civile në hyrje të viteve '90 për shumëkënd mund të ishte e padëgjuar, dhe për masën e gjerë të njeriut të zakonshëm ishte diçka shumë e largët, e pavlerë, sepse mendohej se atje s'ka punë, bukë, drita apo pasuri. Është një dilemë e madhe edhe sot pas 27 vitesh tranzicion në shoqërinë shqiptare, nëse duhet të punojmë për të ndërtuar një shoqëri me më shumë liri, apo një shoqëri që të ndihmon të shpiesh në shtëpi një copë më të madhe buke?!

Ato gra dhe ata burra, djem e vajza të rinj që iu futën punës për të ndërtuar shoqërinë civile edhe në Shqipëri, u grishën nga liria, nga nevoja për ngritjen e oponencës qytetare, nga orientimi për mendimin e lirë, nga domosdoshmëria që shteti duhet mbrojtur edhe në demokraci, që të mos dehumanizohet dhe për pasojë ta harrojë njeriun në nevojë e të bëhet palë dhe ortak vetëm me tregun, me biznesin dhe me oligarkinë.

Pas 25 vitesh të Rotarit në Shqipëri, ne kemi të drejtën dhe detyrimin të themi se ishte një veprim i duhur dhe në kohën e duhur ai që u ndërmor, që Rotary, kjo organizatë mbarëbotërore të hidhte farën edhe në Shqipëri. Mirënjohje atij personi që i pari e tha këtë gjë edhe për vendin tonë. Në një farë kuptimi ai është Paul Harrisi shqiptar. Ishte ish-ambasadori ynë në Itali, zoti Dashnor Dervishi që e kreu këtë veprim të parë për ta sjellë Rotary-n në Shqipëri. Një përpjekje që ishte bërë qysh në kohën e Mbretërisë Shqiptare nuk kishte zënë rrënjë. Ndërsa periudha komuniste kishte organizatat e masave, rripat e transmisionit që lidhnin popullin me partinë, - si edhe thuhej në atë periudhë.

Hap pas hapi, shumë njerëz seriozë, aktivë dhe me dëshirë e energji pozitive prej vullnetari, iu bashkuan kësaj nisme. Ata ishin mjekë, diplomatë, pedagogë, shkencëtarë, e më tej edhe biznesmenë. Sot pas 25 vitesh, është krenari të pohosh se në Shqipëri ka 10 klube rotariane, me rreth 250 anëtarë gjithsej. Ka tashmë të rinj që janë afruar dhe punohet me objektiv për të përfshirë edhe fëmijët, me qëllim për një jetë aktive të organizuar në shërbim të një shoqërie të shëndetshme e dinamike. Komunitetet e paorganizuara krijojnë skarcitete shoqërore, dhe njeriu në këto rrethana mund të humbë drejtpeshimet qytetare shumë lehtë, duke rënë pre e vesit, inaktivitetit, deri edhe krimit.

Sot "Rotary International" është i shtrirë në gjithë botën, me një rrjet organizatash në 200 vende. Është krenari dhe përgjegjësi njëherësh që edhe Shqipëria bën pjesë në këtë hartë rotariane, me klube me një shtrirje nga Korça deri në Shkodër. Edhe shqiptarët janë veprimtarë rotarianë, që nga

Gjirokastra deri në Prishtinë. Ky është një tregues që jo vetëm elitat shqiptare, por edhe masa e gjerë njerëzore e do rotarianizmin, e do lirinë dhe është e përkushtuar për zhvillimin, prosperitetin si dhe për një të ardhme më të mirë. Në këtë përvojë prej dy dekadash e gjysmë, është krejt e përligjur që vlerat universale rotariane si: Bashkimi i liderëve të biznesit dhe profesionistëve me qëllimin fisnik për të ofruar shërbime humanitare, për të inkurajuar standarde të larta etike në të gjitha profesionet, por dhe për të çuar përpara vullnetin e mirë dhe paqen në mbarë botën, të jenë prezente edhe te rotarianët shqiptarë.

Rotary është një organizatë jopolitike dhe josektare, e hapur për të gjithë njerëzit pavarësisht nga raca, ngjyra, besimi, feja, gjinia, ose preferenca politike. Nëse sot numërohen rreth 35.000 klube anëtare në mbarë botën, ku në këtë numër janë të përfshirë edhe klubet shqiptare. Sot në botë ka rreth 1.5 milionë individë të quajtur rotarians, të cilët janë bashkuar me këto klube. Në këtë bashkësi globale të paqes dhe aktivizmit shoqëror, janë dhe burrat e gratë që festuan 25-vjetorin e të parit club Rotary në Shqipëri, në maj 2017. Diçka më shumë se një vit më parë, Presidenti i Rotary-t Ndërkombëtar, zoti Garry K. Huang vizitoi Shqipërinë, çka përkoi me themelimin e Klubit Rotary të Shkodrës. Ky ishte i katërti President i Rotarit Ndërkombëtar që vizitonte Shqipërinë.

Takimet dhe bisedat me të, idetë që shkëmbyem, dhe këshillat që ne morëm ishin me shumë vlerë. Në këtë përvojetor ne përshëndesim të gjithë rotarianët kudo në botë, ata që kanë eksperiencë të gjatë dhe ata që sapo janë përfshirë në këtë organizatë mbarëbotërore. Mesazhi që ne iu dërgojmë atyre dhe presidentit të radhës, zotit John F. Germ, është: "Jemi krenarë që jemi rotarianë. Shqipëria do të shndërrohet në një vend me më shumë liri dhe zhvillim nëse materializon gjerësisht edhe parimet rotariane."

Nëse dikush që nuk e njeh Shqipërinë e sotme të viteve të demokracisë dhe tenton që ta bëjë përmes rrjeteve sociale online apo përmes lexime ve do të marrë goxha informacion. Por jo të mjaftueshëm. Duhet të vish këtu. Shqipëria është një vend që duhet vizituar për t'ia njohur të shkuarën dhe të sotmen, arkeologjinë dhe historinë, traditën dhe ritualin, gjeografinë dhe mentalitetin, zakonet dhe marrëzitë. Ky vend duhet të vizitohet; vetëm në këtë mënyrë do të mund të njihesh me popullsinë dhe problemet e breznive të reja, me jetën institucionale dhe atë politike, me natyrën dhe traditën, me kontributet dhe peripecitë në rrjedhat historike. Por mendoj se Shqipëria duhet vizituar edhe për një arsye që realisht bën arsye. Për të takuar rotarianët shqiptarë, këto gra dhe këta burra seriozë, të përkushtuar, impenjativë dhe shpirtlirë. Rotarakët dhe veprimtaria e tyre në këtë periudhë çerekshekullore është e madhe, e vlefshme, por edhe modeste dhe e pazhurmë. Vaksinimi i fëmijëve të vegjël diku para 20 viteve kundër hepatitit siguroi që sot të kemi të rinj të shëndetshëm. Nëse 50 mijë fëmijë shqiptarë të Kosovës u ulën në ditën e parë të shkollës dhe hapën abetaren shqip duke lexuar ABC-në, mund të mos e dinin se kush e kishte bërë atë dhuratë bujare dhe me vlera kombëtare, por sot që janë rritur e maturuar, dinë që ata libra që hapën dyert e jetës për ta, ishin dhuratë e rotarianëve nga Shqipëria. Nëse sot në universitete të botës ka studentë shqiptarë të ekselencës që ndjekin studimet universitare dhe post-universitare me mbështetjen financiare të Rotarit, ky është një tregues që rotarianët shqiptarë punojnë pa u ndalur për të sjellë një të ardhme më të mirë për vendin dhe më shumë paqe për shoqërinë globale. Nëse qyteteve iu shtohet hijeshia me pemët e mbjella atje, janë dhe rotarianët me kontributet e tyre modeste. Nëse njerëzit në nevojë kërkojnë një derë të hapur, ajo është dera e rotarianëve që kontribuojnë me mbështetje.

Ne rotarianët jemi shembulli pozitiv, ne jemi modeli që duhet konsideruar edhe nga shteti dhe institucionet e tjera. Madje duhet të merremi shembull edhe nga operatorët e shoqërisë civile. Ndodh kështu, sepse motoja jonë e punës dhe motivi është ai universali për të gjithë rotarianët. "Shërbimi është mbi interesat vetjake" dhe "fitimi është më i madh kur shërben më mirë". Ambienti ynë i hapur miqësor tolerant dhe bashkëpunues është shembull edhe për politikën zyrtare, që shpesh vuan nga konflikti dhe ndarja. Mënyra se si ne funksionojmë, duke ndërruar personin në drejtimin një herë në vit në mënyrë demokratike, është një shembull kuptimplotë për të gjithë shoqërinë. Me keqardhje ne vëmë re se jo vetëm në organet shtetërore, por edhe në operatorët e shoqërisë civile, drejtuesit e tyre, sa hipin në poste, më shumë mendojnë dhe përpiqen të mbeten atje gjatë, mundësisht sa më gjatë, sesa të realizojnë punë të dobishme dhe të bëjnë realitet premtimet e shpallura më herët. Rotarianët në të gjithë Shqipërinë, klubet më të vjetra, por edhe ato më të rejat, janë të tillë që gëzojnë respektin e gjerë të komunitetit. Një sjellje e tillë nuk është thjesht shprehje e konformizmit për shkak të edukatës civile. Respekti që rotarianët gëzojnë kudo është i lidhur me personalitetin e secilit prej nesh, me aktivitetin dhe dinjitetin njerëzor, me frymën solidare dhe me përkushtimin qytetar, ka të bëjë tek e fundit me sjelljen individuale, por edhe atë komunitare të rotarianëve. Në këtë përvjetor është rasti dhe vendi të themi edhe diçka tjetër. Historia e Shqipërisë, e vjetra dhe e reja, do ishte jo e plotë, nëse rotarianët nuk do të kishin ngritur folenë edhe në vendin e shqiponjave. Ne jemi krenarë për veten dhe familjet tona, por ne jemi krenarë gjithashtu se qytetet ku janë klubet tona, e kanë në ndërin e tyre si dhe një vlerë të shtuar të CV-ve, që atje veprojnë klubet rotariane. Edhe Shqipëria e Kosova janë krenare që shqiptarët janë misionarë të rotarianizmit në trevat e tyre.

Gjuhët zyrtare të rotarianizmit janë disa, dhe konkretisht: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, japonisht, koreane, portugeze dhe spanjolle. Ne në këtë përvjetor të 25-të të Rotarit shqiptar duam të themi me zë të lartë: Rotarianizmi flet edhe shqip. Ky fakt i bën nder "Rotary International", na bën nder edhe neve. Kur udhëhiqesh nga liria dhe humanizmi, sado e vështirë të jetë situata dhe komplekse të jetë gjendja, njeriu e gjen motivin. Ashtu si bëri Paul P. Harris kur vendosi të themelonte këtë klub. Historia tashmë është e hapur. Ne udhën e dimë, na mbetet vetëm të ecim pa u ndalur!

Opinioni i Ditës

Skënderbeu "hungarez" dhe patriotizmi tenderist

Bujar Vani

(Vijon nga faqja e parë)

... jo nga natyra por nga atmosfera mediatike. Dikush u kujtua të ngacmonte ndjesitë patriotike e patetike dhe të rriste tensionin nervor të opinionit publik shqiptar duke hedhur në "betejë" mediatike pikërisht figurën emblematike të Heroit kombëtar, Skënderbe. Por nëse njëra "betejë" duket se kishte një prapavijë të qartë qëllimore e do të vazhdojë më gjatë për shkak të vetë platformës mbi të cilën është hartuar dhe hedhur në tregun mediatik, por që nuk është objekt i këtij shkrimi, beteja tjetër ngjau me një "blic krieg", e cila në aparencë mori zgjidhje shumë shpejt, por që hodhi një tymnajë qorrollisëse dhe la një shije të hidhur në opinionin e gjerë.

E gjitha nisi me disa foto të hedhura në rrjete sociale nga ambasadori ynë në Hungari, z. Arian Spasse, mbi një projekt shtatoreje të Skënderbeut që është planifikuar të vendoset në një park të Budapestit, përballë monumentit të Huniadit. Reagimi qe i menjëhershëm, por nuk pati debat profesional, vetëm se u hodhën parulla patriotike me shumicë, e shumëkush e mori si një provokim të radhës që përkonte me debatin tjetër që po zhvillohej në opinionin mediatik e publik shqiptar mbi origjinën e familjarëve të heroit. Gati-gati u pa si një "komplot i koordinuar" me bazë të gjerë kundër historisë shqiptare dhe posaçërisht ndaj Heroit kombëtar Skënderbe.

Në fakt, nuk mund të gjykojmë mbi opinionin qytetar i cili me të drejtë reagon kur preket ndjeshmëria kombëtare, edhe pa kuptuar inskenimet djallëzore të atyre që e orientojnë atë mbi tema të nxehta dhe delikate për mendësinë dhe vetëdijen popullore. Por, arsyeshmërisht lind e drejta e një analize të përmbledhur mbi vetë dukurinë, domethënë mbi thelbin e problemit, realitetin, shkaqet dhe protagonistët që ngjallën këtë reagim, si dhe "zgjidhjen demokratike" që shoi reagimin:

- Pikësëpari, skulptori hungarez ka marrë përsipër realizimin e një vepre artistike figurative që do të vendoset në një mjedis publik të rëndësishëm të kryeqytetit të tij dhe nuk mund të luajë sipas "komploteve denigruese" me personazhin-objekt. Ndërkohë që nuk ka asnjë shkas të qenësishëm të hidhen insinuata absurde ndaj palës hungareze, qoftë edhe politikisht apo kombëtarisht, njëlloj siç mund të ngrihen me arsye ndaj ballkanikëve të tjerë, pasi qëndrimi hungarez në të gjitha kohët ka qenë ai i një aleati të sinqertë kombëtar ndaj shqiptarëve, ashtu si edhe ai i kroatëve.

- Më tej, vepra konkrete (që ambasadori ynë thotë se është ende maket) është një kompozicion sipas përfytyrimit artistik e estetik

të skulptorit Mihaly Grabor, i cili ka zgjedhur një frymë naiviste në paraqitjen e Skënderbeut, edhe pse duhet thënë se realisht është një punim i dobët estetikisht (të paktën në ato foto që janë dhënë publikisht). Vetëm se duhet kuptuar që, nëse për shqiptarët Skënderbeu është Heroi kombëtar, për një hungarez (apo këdo tjetër të huaj) ai është një personazh historik. Dhe janë të ndryshme premisat ideore e konceptuale që ngjizin kompozicionin artistik të figurës së: një personazhi historik, një heroi apo një figure mitike. Kuptohet që, në realizimin e një vepre figurative me objekt personazh historik apo ngjarje historike duhen pasur parasysh parametra që diktohen nga realiteti objektiv, por tej këtij realiteti objektiv janë edhe parametrat artistikë, domethënë fuqia shprehëse apo përfytyruese e vetë artistit. Cilësorët mbi të cilët mund të gjykohet atëherë kjo vepër arti u takojnë çështjeve të unikalitetit kompozicional, shprehësisë estetike të figurës, trajtimit të formës e sipërfaqes, harmonisë së figurës në tërësi me vetveten dhe mjedisin ku do të vendoset etj. Në rast të kundërt, nuk kemi të bëjmë më me një vepër arti, por me një vepër ilustrative, që mund të jetë porosi për ndërmarrjen e dekorit të qytetit e jo për një artist.

- Por nga ana tjetër, pikërisht kur u mendua se po flisnin profesionistët mbi këtë punim figurativ, reagimi i tyre degradoi në një fushatë nxitjeje patetike "patriotizmi" të opinionit publik, duke akuzuar autorin për deformim të figurës historike, dhe duke dhënë deklarime aspak profesionale, por të karakterit politik, me mbathje "argumentesh" antropologjike e politologjike, në variantin e parullave propagandistike, kinse për të ngritur temperaturën e këtij opinioni publik, e jo për të dhënë një kuptueshmëri profesionale mbi objektin në fjalë.

- "Argumenti" themelor u duk se për ta ishte fizionomia e portretit e jo kompozicioni i veprës në përgjithësi. Dhe reagimet e mëtejme u fokusuan dukshëm pikërisht mbi këtë element, aq sa dhe "zgjidhja" që u gjend pas këtij reagimi ofron një ndryshim të kësaj fizionomie në përafrim të imazhit "real" të Skënderbeut. Natyrisht, në përfytyrimin e përgjithshëm publik është ngulitur imazhi i Skënderbeut në variantin e dhënë nga busti që i njihet skulptorit Odise Paskali, për shkak dhe të përhapjes masive të tij. Por ai është përfytyrimi i këtij autori për Heroin kombëtar dhe jo "realiteti objektiv" i mirëqenë që jep tiparet reale të këtij personazhi historik. Mjerisht, teknika fotografike ka lindur shekuj më vonë se koha kur jetoi dhe veproi Heroi! Edhe gravurat që na vijnë ndër botimet e hershme mbi të janë kaq të ndryshme sa ç'janë dhe përfytyrimet e autorëve që i kanë kompozuar. Prandaj, kërkesa për një fizionomi sa më autentike në veprën "hungareze" përkthehet në pretendimin se "e duam Skënderbeun si të Paskalit", sepse ky është dhe përfytyrimi më i përhapur mbi të, edhe pse në galerinë e veprave skulpturore mbi heroin kemi karaktere të tjera fizionomike, si në rastin e skulptorit Janaq Paço. Ndërsa "argumenti" antropologjik se Skënderbeu "hungarez" nuk ngjan si shqiptar, por si serb, hungarez apo bullgar, i artikuluar nga profesionistë të artit figurativ, ngjan infantil dhe në padijeni të plotë antropologjike kur këto tre modele i përkasin tre racave të ndryshme të pangjashme me njëra-tjetrën.

- Po, mund të themi, sipas gjykimit tonë, se ajo figurë është thjesht një realizim i dobët artistik dhe estetik, skulpturë e karakterit naivist, ku sinqeriteti i autorit duket qartë, por pa u shtyrë më tej në paragjykime të karakterit politik mbi dashakeqësinë e autorit. E nëse është e tillë, vetë kritika hungareze do të reagonte në vijim, pasi nuk mund të lejonte që një vepër e dobët të vendosej në mjedisin urban të kryeqytetit të tyre. E mbi këtë premisë të ngrihej edhe reagimi profesionist i palës shqiptare, që do të ishte i natyrshëm dhe do të mbeste brenda caqesh racionale të gjykimit të një vepre artistike.

- Në të kundërt, beteja mediatike "patriotike" nisi pikërisht nga ajo anë që, për çudi, nuk ka reaguar ndonjëherë për vepra të tjera edhe më të dobëta, edhe më pak përfaqësuese mbi Heroin kombëtar Skënderbe, por edhe mbi vepra të tjera skulpturore që "stolisin" mjedisin urban në qytetet shqiptare, por edhe disa punime në qytete të tjera europiane, që jo vetëm nuk japin atë fizionomi që i kërkohet Skënderbeut "hungarez", por janë modele të përçudnimit artistik e estetik. Ky lloj patriotizmi selektiv atëherë i bie të gjykohet se ka pasur shkaqe e motive të tjera, që për t'u kamufluar nxitën ndjesitë patriotike të opinionit publik, gatigati deri në një "plebishit popullor" kundër Skënderbeut "hungarez". Dhe po përmes këtij "plebishiti" u arrit dhe fitorja: mbas ndërhyrjes së ambasadorit shqiptar në Budapest, "maketi do të pësojë ndryshime, derisa të marrë tiparet me të cilat shqiptarët janë familjarizuar"! Por plebishitet qytetare mund të jenë të vlefshme për të marrë miratimin e vendosjes së një vepre artistike në mjedisin publik, por jo edhe për të ndryshuar një vepër arti. Nuk njihet në historinë e artit që veprat të jenë realizuar me plebishite popullore, madje edhe pllakatet e dekorit dikur bëheshin me orientime partie e jo me formën demokratike të plebishitit... Më tej, në një vepër arti, nëse është e tillë, nuk vendos ambasada e as populli, e as e detyron dot artistin që të bëjë ndryshime në vepër. Nëse një zgjidhje kompozicionale argumentohet përse nuk përfaqëson personazhin në tërë kompleksitetin shprehës, ajo zgjidhje nuk riparohet nga tiparet fizionomike të portretit, as nga gjendja psikologjike, pasi kjo do të ishte pa teprim amatorizëm gjykimi dhe realizimi. Por kur gjykojmë kompozicionin naivist të rëndomtë, të dobët të hungarezit, apo inkoherencën formale brenda punës së tij, si nuk janë ndjerë shqetësime publike për morinë e madhe të monumenteve "tallava" në Shqipëri, që janë edhe më të dobëta artistikisht e estetikisht se ajo e Hungarisë?

Atëhere lind e drejta të shtrojmë pyetjen: Përse gjithë kjo zhurmë, pse kjo fushatë kryqëzuese me tone të rënda politike e diplomatike, kur nuk ka ndodhur më parë për vepra të tjera? Ndoshta, për vetë faktin që ambasada arrin të ndërhyjë në një vepër arti, çështja duhet të jetë punë konkursesh e tenderësh, ku janë prekur interesat e dikujt apo të disave që janë mësuar të kontrollojnë e të përvetësojnë porositë e këtij karakteri, dhe vepra "hungareze" mund të jetë një porosi e palës shqiptare dhe sedra e interesat e profesionistëve shqiptarë janë cenuar. Por atëherë beteja nuk paska qenë parimore, madje as çështje lëndimi të sedrës kombëtare, por mund të etiketohet si "patriotizëm tenderist", që manipulon në mënyrë të shëmtuar ndjenjat dhe vetëdijen e opinionit publik.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Henri që qe piktor.
6. Janë si kështjella
12. Maiden që këndojnë.
13. Janë enë benzine
14. Është melodramë.
17. Është vegël.
18. Gjysmë sterile.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Ishte zogu simbol i Jezu Krishtit.
24. Ai dhe ajo.
27. Janë sëmundjet që përhapen.
29. Gjëja e romakëve.
30. Shenjtorja që iu pre koka.
31. Camus që shkroi I huaji.
34. Fillojnë ilustrimet.
36. Dieta pa ekstreme.
37. Ndërmarrje Autonome Sarandë.
40. Mund të jenë postare.
42. Ekstreme në sirtar.
43. I mungon asaj që i ka kaluar koha.
46. Një ekip... anglez
47. Ente Ekonomike Rajonale.
48. Një llahtar.
51. Transporton edhe maune në det.
52. Quinn aktor.

VERTIKAL
1. Fillojnë mirë.
2. Nuk i tregohen babait.
3. Në hyrje të tokës.
4. Gruaja e dytë e Atamantit.
5. Merren në bllok
6. Kalimi në kufij
7. Qe burri i parë.
8. Frolich e Marlene Dietrich.
9. Kanë aderuar në parti.
10. Shteti pa shi.
11. Një pjesë e etiketës.
13. Një pelg.
15. Janë kundërshtarë në gjyq.
16. Është pije e jona.
18. Luhen me 1. X, 2
19. Mbretëria e Pirros.
21. Braktisi Didonën.
23. Emri tjetër i Esaut.
25. Një pjesë e territorit.
26. Një copë për xhepa.
28. Janë patriotë të Chopin.
32. Ray aktor.
33. Mund të jetë solemn
35. Alessandro, bomber te Juventus.
38. Ylli i Londrës
39. Sapo fillojnë
40. Emri i Mondrian.
41. Kufizojnë katete.
42. Lindi Isakun.
44. Thurman aktore.
45. Në mes të Tommy dhe Jones aktor
49. Harris aktor.
50. Një rajon kur s'është ajo.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Gardner që qe aktore.
4. Në krye të bashkisë .
6. Emër vajze.
9. Fillojnë pushimet.
10. Janë si biskota
14. Të fundit në ditar.
15. Janë trupa pa kënde.
16. Fillojnë notimin.
17. Në radhë të parë.
18. Pak latinisht.
20. Është gjendje të fikti.
23. Është vërtet e mërzitshme.
24. Një mund të jetë fetar
26. Gjysma e sallës.
27. Pak dorështrënguar.
28. Rastisin në krye.
29. Një... dollar.
30. Një pjesë e etiketës.
31. Skuadra e Moratti-t.
32. Ego... ime.
33. Është sport me stil të lirë.
35. Ekstreme ekstremi.
36. Një mbishkrim në kryq.
39. Kanë brirë piktoreské të tillë.
41. Një vendës autokton.
42. Argento aktore.
44. Një Behar, aktor komik.
46. Ka tre muaj.
48. Një fjalë si asnjëherë .
50. Në krye të armiqve.
51. Janë legjenda.
52. Flet për të bukurën.

VERTIKAL
1. Një thirrje me emra.
2. Vulosen të parat
3. Këndojnë me zë të trashë të tillë
4. Një mund të jetë armë.
5. Mbyllin fushatat
6. Një grimcë me bërthamë.
7. Dacia shkrimtare
8. Është lloj papagalli
10. Fillojnë afrimin
11. Kapet një me fishkkëllimë.
12. Mbahet në mbledhje.
13. Ekberg aktore.
15. Janë zbukurime.
19. Janë diletantë .
21. Janë zonat e kufizuara
22. Janë tallësit.
25. Fillojnë temën
26. Një gjë.
32. Bëhen për të mirë
34. Është shtet aziatik.
37. Inicialet e Nolte aktor.
38. Shkruhet në janar.
40. Teliti regjisor.
43. Një pjesë e dramës.
45. Rastet pa set.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Të fundit në studim.
49. Kufijtë e rritjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

1		5			2			7
			5			1	9	2
	7			4	8	6		
	6	1		3				8
8			4		6			9
3				1		7	2	
		9	7	6			3	
7	8	3			1			
4			3			2		5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	9	4	3	1	7	2	5	8
3	1	8	5	2	6	9	4	7
5	2	7	8	4	9	6	3	1
7	8	5	2	6	3	1	9	4
1	3	6	9	8	4	5	7	2
9	4	2	7	5	1	8	6	3
4	5	3	1	9	2	7	8	6
2	6	9	4	7	8	3	1	5
8	7	1	6	3	5	4	2	9

Argëtim filozofik

- "Ne jemi ajo ç'ka bëjmë vazhdimisht. Përsosmëria nuk është një akt, por një zakon".

Aristoteli

- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.

- Bota është plot vuajtje, ashtu sikurse është plot shembuj për kapërcimin e tyre.

Helen Keller, shkrimtare (1880-1968)

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	U	L	M	■	S	M	■	M	A	S	A	T		
A	R	■	B	E	■	E	M	■	L	I	M	A		
K	■	D	E	L	E	G	A	T	E	T	■	L		
■	M	I	T	O	M	A	N	E	T	■	D	E		
K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	■	N		
O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	■	F	T		
■	■	N	I	■	E	N	O	■	■	G	A	■		
P	■	S	N	■	N	I	■	M	A	L	L	I		
A	M	I	A	N	T	■	K	■	■	O	S	E		
N	■	O	T	■	E	K	I	P	O	R	E	■		
I	T	N	■	E	T	I	L	E	N	I	■	E		
K	R	I	M	I	■	S	I	R	T	A	K	I		

FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

Argëtim filozofik

Ehënie të mençura

- Mënyra e vetme për të jetuar, është të pranosh çdo minutë të kësaj jete si një mrrekulli të papërsëritshme. **(M. Storm Xhejmson)**

- Mediokriteti nuk njeh asgjë më të lartë se veten e vet. **(A. Konan Doil)**

- Nga mundi i yt do të jesh i ngopur, por jo edhe i pasur.
Gjithë fatkeqësia vjen kur njeriu kërkon të rrojë pa fituar, të fitojë pa punuar, të punojë pa u lodhur.

Nga Mid'hat Frashëri

HOROSKOPI

DASHI

Do ndjeheni të nervozuar në mëngjes, nën presionin e Hënës në trekëndësh me Uranin. Diskutime të shumta sidomos për objektivat personale dhe ekuilibrin në çift. Pasditja ju jep siguri, për më tepër Hëna ndërron shenjë, ashtu siç ju ndryshoni humorin.

DEMI

Do e filloni të dielën më një mëngjes të bukur romantik me të dashurin tuaj. Më vonë efekti magjepsës i Hënës do zhduket, aq sa ndryshimi i pozicionit të saj do t'ju vërë në provë. Ruani qetësinë dhe përpiquni të reagoni ashtu si duhet.

BINJAKET

E diel premtuese, falë kalimit të Hënës pasdite në trekëndësh që shton energjitë tuaja, duke ju nxitur për aventura të reja. Pasion i madh për udhëtimet, me miqtë flisni më tepër se duhet por tani ka ardhur momenti të reagoni!

GAFORJA

Një ndryshim i papritur në lidhje me programet e parashikuara për sot duhet të merret parasysh, me Hënën dhe Uranin jo në harmoni të plotë. Është momenti të mendoni për pushimet tuaja, ka ardhur koha të qetësoheni.

LUANI

Në mëngjes do fokusoheni te problemet familjare, pavarësisht dëshirës për të ndryshuar rutinën e së dielës, ndoshta me ndonjë udhëtim të shkurtër dhe zbavitës. Çdo gjë duket sikur po ikën shumë shpejt këtë të diel, mungesa e programeve të përcaktuara ju bën më gazmor.

VIRGJERESHA

Të përkëdhelur nga Hëna, do shijoni një ditë të këndshme për t'iu përkushtuar shëtitjeve të shkurtra në mal ose ndonjë aktiviteti në natyrë. Dëshira për të bërë shpenzime nuk ju mungon. Pasditja ju rezervon surpriza të këndshme!

PESHORJA

Do jeni të zymtë në mëngjes por pasdite, me kalimin e Hënës në shenjën e Dashit, humori do përmirësohet dhe do ndjeheni më energjik. Mbrëmje ideale për të marrë pjesë në një festë në shoqërinë e miqve tuaj të dashur.

AKREPI

Të lumtur dhe të gëzuar gjithë mëngjesin. Pasdite do ndjeheni pak të lodhur, ju duhet pak pushim për të marrë veten. Mos tentoni të anuloni planet e darkës! Është më mirë të sforcoheni pak sesa të zhgënjeni personat që ju rrethojnë.

SHIGJETARI

Do zgjoheni me humor të keq për shkak të Hënës që ju kundërshton. Megjithatë shpejt do ndryshoni mendim duke ju përkushtuar projekteve që keni në mendje. Është e kotë të pretendoni që t'i realizoni gjërat shpejt, çdo gjë ka nevojë për kohën e vet.

BRICJAPI

I shikoni gjërat me optimizëm të madh. Do tregoni elasticitet dhe shpirtin e përshtatjes para një ndryshimi të papritur në programet tuaja. Falë mbështetjes së Uranit do thyeni rregullat dhe zakonet. Ndërmerrni iniciativa të reja nëse doni të triumfoni.

UJORI

Mëngjes jo shumë aktiv, por pas dreke Hëna arrin në shenjën tuaj dhe do ndjeheni më shumë energjik. Gjeni kohë për miqtë tuaj, keni nevojë për zbavitje. Pak të pakapshëm në dashuri, partneri juaj mund të ketë nevojë për siguri dhe stabilitet.

PESHQIT

Megjithëse të gatshëm për të ndihmuar të tjerët, jeni të rezervuar dhe nuk i shprehni ndjenjat dhe emocionet, duke shmangur diskutimet për veten tuaj. Ide konfuze në lidhje me një udhëtim që keni planifikuar, diçka ju pengon për të rezervuar biletën.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!